



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ  
Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT  
Republic of Macedonia  
O M B U D S M A N

# PËRFSHIRJA E FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË ARSIMIN PARASHKOLLOR

Raporti i  
hulumtimit





PËRFSHIRJA  
E FËMIJËVE ME  
AFTËSI TË KUFIZUARA  
NË ARSIMIN  
PARASHKOLLOR

Raporti i  
hulumtimit

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

373.24:376-053.2-056.26/.36(497.7)(047.31)

376-053.2-056.26/.36:373.24(497.7)(047.31)

ВКЛУЧЕНОСТ на децата со попреченост во предучилишното образование : извештај од истражување. - Скопје : Народен правобранител на Република Македонија, 2018. - 99, 99 стр. : илустр. ; 25 см  
Насл. стр. на припечатениот текст: Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor : raporti i hulumtimit. - Обата текста меѓусебно печатени во спротивни насоки. - Текст на мак. и алб. јазик. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4715-50-4

а) Деца со попреченост - Предучилишно образование - Инклузија - Македонија - Истражувања

COBISS.MK-ID 108657418

Avokati i Popullit, në përputhje me Programin vjetor për vitin 2018, dhe me ndihmë financiare nga UNICEF-i, e zbatoi hulumtimin mbi përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor.

Falënderim të posaçëm për Shoqërinë për teknologji ndihmëse “Hapni dritaret” nga Shkupi, për hulumtimin e kryer për nevojat e Avokatit të Popullit.



Проектот е  
финансиран од  
Европската Унија



PËRMBAJTJA

**7** HYRJA

**10** QËLLIMET DHE FUSHA E HULUMTIMIT

- 11 Lënda dhe qëllimet e hulumtimit
- 12 Përcaktimi i termave të përdorur
- 12 Karakteristikat e ekzemplarit

**18** METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

- 19 Metodatat e hulumtimit
- 20 Korniza kohore

**22** INKLUZIONI I FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE - KOPSHTET E FËMIJËVE

- 23 Gjetjet kryesore nga hulumtimi në terren

**30** PËRFAQËSIMI I FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË ARSIMIN PARASHKOLLOR

- 31 Përfaqësimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor
- 41 Përfshirja në kopshte
- 50 Përvoja dhe praktika
- 56 Komente shpeshë
- 57 Rrëfime nga terreni

**60** VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

**66** REKOMANDIME

**70** SHTOJCA



HYRJA



**Mbrojtja e fëmijëve** është një aktivitet i organizuar në bazë të të drejtave të fëmijëve, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve për planifikimin e familjes dhe të shtetit dhe njësisive të qeverisjes lokale për zbatim të politikave humane të popullimit.<sup>1</sup>

Kujdesi dhe edukimi i fëmijëve në moshën parashkollore është një formë e mbrojtjes së fëmijëve që organizohet si një aktivitet për kujdes, qëndrim, ushqim, aktivitete arsimore-rekreative, aktivitete kulturore dhe argëtuese, masa dhe veprime për të përmirësuar dhe për të ruajtur shëndetin dhe për të nxitur zhvillimin intelektual, emocional, fizik, mendor dhe shoqëror të fëmijës deri në moshën gjashtëvjeçare, domethënë deri në përfshirjen në arsimin fillor. Në vendin tonë, arsimi parashkollor zhvillohet në institucionet parashkollore, domethënë në kopshte. Gjatë pritjes, kujdesit dhe edukimit të fëmijëve, kopshtet janë të detyruar që të sigurojnë standardet minimale për çdo fëmijë nën kushte të barabarta pa asnjë formë të diskriminimit. Nevoja për këto institucione, si dhe në të gjithë sistemin arsimor në përgjithësi, është të sigurojnë kushte për zhvillim të potencialit maksimal të secilit fëmijë.

Zhvillimi i hershëm i fëmijës është një periudhë tepër e rëndësishme për formimin e personalitetit të fëmijës. Në botën tonë, sidomos në vitet e fundit, u krijua një korpus njohurish nga fusha e psikologjisë, epigjenetikës dhe të disiplinave të tjera, që nxjerr në pah kuptimin thelbësor të periudhës të moshës nga 3-5 vjeç për zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës. Pikërisht kjo periudhë, kur truri zhvillohet më

<sup>1</sup> [http://www.mtsp.gov.mk/detska-zashtita-ns\\_article-zgrizuvanje-i-vospitanie-na-deca-od-preducilishna-voznost.nsp](http://www.mtsp.gov.mk/detska-zashtita-ns_article-zgrizuvanje-i-vospitanie-na-deca-od-preducilishna-voznost.nsp)

shumë, është kyçe për aftësitë kognitive dhe jokognitive të cilat i zhvillon fëmija.<sup>2</sup>

Prandaj rëndësia e kopshtit, e jo vetëm për shkak të funksionit të tyre strehimi, por theksi më i madh vihet mbi punën edukative, reflektohet në përfshirjen e tyre në sistemin e edukimit dhe arsimit. Kopshtet e fëmijëve si pjesë e sistemit të rregullt edukativo-arsimor duhet të mundësojnë pjesëmarrje aktive dhe të barabartë për të gjithë fëmijët. Me qëllim që të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në procesin arsimor, fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për mbështetje individuale dhe për një qasje të individualizuar.

Me qëllim që të zbulojnë situatën me përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe që të analizojnë nëse kushtet dhe përpjekjet që po ndërmerren e ofrojnë kujdesin dhe edukimin e duhur, Avokati i Popullit në pajtim me Programin Vjetor të Punës ka zbatuar një hulumtim i cili është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të monitorojnë situatën me përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim dhe në shoqëri në përgjithësi. Ky hulumtim është vazhdim i hulumtimeve të zbatuar nga ana e Avokatit të Popullit mbi përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor dhe të mesëm të rregullt, i zbatuar në periudhën të mes viteve 2015 dhe 2017, dhe ka për qëllim të ofrojë rekomandime që do të sigurojnë qasje të barabartë dhe cilësor për qasje dhe qëndrim për të gjithë fëmijët në kopshtet.

---

**2** Qendra për Zhvillim të Hershëm të Fëmijës në Universitetin e Harvardit (Harvard Centre on the Developing child, <https://developingchild.harvard.edu/>) publikon punime të shumta në këtë fushë.





QËLLIME DHE  
FUSHA E  
HULUMTIMIT

## LËNDA DHE QËLLIMET E HULUMTIMIT

**Lënda** e këtij hulumtimi të nevojave është përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor në vendin tonë.

Kuptimi i përfshirjes (inkluzionit) nis nga qasja e themeluar mbi të drejtat e njeriut dhe nënkupton sigurim i të drejtat e barabarta për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrja e tyre të barabartë me të gjithë fëmijët e tjerë. Pika nisëse për këtë kuptim mbi kufizimit janë vlerat dhe parimet të përcaktuara me dokumente relevante ndërkombëtare, në radhën a parë Konventa e KB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Deklarata e UNESCO-s për arsim të bazuar mbi nevojat e posaçme nga Salamanka.

Qëllimi themelor i këtij hulumtimi është ta pasqyrojë gjendjen aktuale me përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet publike për përkujdesje të fëmijëve – kopshtet e fëmijëve, aksesueshmëria dhe disponimi i kopshteve për fëmijët me aftësi të kufizuara, gjendja aktuale si me kornizën ligjore për ushtrimin e të drejtës, kuptimin, percepticionit, si dhe praktika e inkluzionit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në këto institucione publike në vendin.

Në këtë kontekst, hulumtimi u zbatua me qëllim që:

- 1 të sigurojë pasqyrim mbi përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet parashkollore,
- 2 të përcaktohet gatishmëria e institucioneve parashkollore dhe sfidat me të cilat përballohen gjatë sigurimit të mundësive të barabarta për përfshirje të të gjitha fëmijëve,
- 3 të zbulohen qëndrimet dhe kuptimet e kuadrit që punon në institucionet parashkollore në lidhje me kuptimin dhe pranimin e konceptit të gjithëpërfshirjes, dhe
- 4 të identifikohen mundësitë dhe nevojat për përmirësim të mëtejshëm të gjithëpërfshirjes të arsimit parashkollor te ne.

## PËRCAKTIMI I TERMAVE TË PËRDORUR

Për qëllimet e këtij hulumtimi, termi "nxënësit me aftësi të kufizuara" nënkupton nxënësit që përballen me një nga llojet e mëposhtme të pengesave:

- ▶ kufizime fizike (vështirësi në lëvizjen e krahëve, këmbëve ose të gjithë trupit, paralizë cerebrale, përdorimin e mjeteve ndihmëse për lëvizje si karroca etj.)
- ▶ përkufizime intelektuale (pengesa në zhvillimin intelektual),
- ▶ dëmtime shikimi (të cilat janë me natyrë më të vështirë dhe pengojnë nxënësin në ndjekjen e mësimdhënies),
- ▶ dëmtimi i dëgjimit dhe/ ose i të folurit (që janë me natyrë më të vështirë dhe pengojnë nxënësin në ndjekjen e mësimdhënies),
- ▶ ndonjë përkufizim i kombinuar (kombinim i disa pengesa të ndryshme),
- ▶ autizmi (spektri autistik i çrregullimeve), dhe
- ▶ gjendje të tjera të ngjashme që shkaktojnë vështirësi në të nxënit (hiperaktivitet, mungesa e vëmendjes) etj.


Termi "institucioni parashkollor" për nevojat e këtij hulumtimi përdoret për kopshtet në Maqedoni, duke i përfshirë kopshtet private.

## KARAKTERISTIKAT E EKZEMPLARIT

Nëpërmjet tri metodave të përdorura në hulumtimin në terren- anketa, intervista dhe fokus grupet – u përfshinë ekzemplarët përfaqësues me karakteristikat e mëposhtme në aspektin e fushës dhe strukturës:

Me anketën, nëpërmjet pyetësorit i cili u shpërnda në të gjitha institucionet parashkollore – kopshte e fëmijëve, me analizën ishin

përfshirë 89 përqind, domethënë 58 kopshte, nga 65 gjithsej, të cilat kanë kthyer përgjigje. Në këtë numër nuk janë përfshirë kopshtet private.<sup>3</sup>




### **PASQYRA 1: Numri dhe përqindja e institucioneve parashkollore të përfshira në hulumtimin me anketa**

Në vitin aktual 2017/18, në kopshtet që dorëzuan përgjigjen e pyetësorit ishin përfshirë gjithsej 34.700 fëmijë. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, në vitin 2017 (gjendja në 30 shtator), numri i përgjithshëm i fëmijëve në institucionet për përkujdesje dhe edukim – kopshte për fëmijë/ qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijëve është 35.286. Prej këtij numri, 34.155 janë fëmijë që janë përfshirë në kopshtet publike që u mbuluan me hulumtimin<sup>4</sup>. Të dhënat shtese për numrin e fëmijëve të përfshirë në kopshtet në vitin aktual 2018, tashmë nuk është publikuar (të dhëna të këtilla nuk është në disponim në faqen e internetit të Entit Shtetëror të Statistikës, duke pasur parasysh se Enti i publikon këto të dhëna në shtator, me fillimin e vitit shkollor).

Kopshtet që i janë përgjigjur pyetësorit (58) janë të vendosura në të tetë rajonet planore në Maqedoni: shumica janë nga rajoni i Shkupit (17), kurse më pak pyetësorëve u janë përgjigjur nga rajoni i Pollogut (2). Ky ndryshim në favor të kopshteve nga rajoni i Shkupit është për shkak të faktit se shumica e kopshteve të vendit janë të vendosura në rajonin e Shkupit.

<sup>3</sup> Pyetësorit nuk i janë përgjigjur kopshtet e mëposhtme: “Goce Dellçev” – Probishtip, “Raspeana Mlladost” – Shkup, “Snezhana” – Shkup, “8 Prill” – Shkup, “Fillizi” – Shkup, “Jabollçinja” – Jegunovc, dhe “Pranvera” – Vrapçisht „.

<sup>4</sup> Burim: Enti Shtetëror të Statistikës, Statistika nëpër fusha: Mbrojtja shoqërore dhe shëndetësore <http://www.stat.gov.mk/PrikaziSooostenie.aspx?rbtxt=25>, vizituar me datë: 16.07.2018



### **PASQYRA 2: Shpërndarja sipas rajoneve planore të kopshteve të cilat i janë përgjigjur pyetësorit**

Me **intervistat** u përfshinë kopshtet, të përzgjedhura nga ekipi hulumtues në konsultim me Avokatin e Popullit dhe UNICEF-in. Përzgjedhja është bërë në bazë të përgjigjeve të marra nga pyetësorët, duke marrë parasysh disa faktorë:

- ▶ rajonin planor ku ndodhet kopshti (u përfshi të paktën një kopsht prej secilit rajon planifikor të vendit),
- ▶ përfaqësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopsht, domethënë u përfshinë kopshte ku ka, por edhe kopshte ku nuk ka fëmijë me aftësi të kufizuara, dhe
- ▶ gjuhën në të cilën zbatohen aktivitetet në kopshtet.

U përfshinë kopshte nga të gjitha rajonet në vend.

Rajoni malor	SH	L	VL	VR	PE	PO	JP	JL	Gjithsej
Numri i kopshteve të intervistuar	8	1	1	1	1	1	1	2	<b>16</b>

### **PASQYRA 3: Numri i kopshteve të intervistuar sipas rajonit<sup>5</sup>**

Sa i përket përfaqësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, sipas përgjigjeve të paraqitura në pyetësorë, nga 16 kopshtet e intervistuar,

<sup>5</sup> SH-Rajoni i Shkupit; L-lindor; VL-verilindor; VR-Rajoni i Vardarit; PE-Rajoni i Pellagonisë; PO-Rajoni i Pollogut; JP-jugperëndimor; JL-juglindor



njëmbëdhjetë (11) përfshijnë fëmijë me aftësi të kufizuara, ndërsa pesë (5) kopshte nuk përfshijnë.

U zbatuan katër **fokus grupe** në të cilat u përfshinë 39 persona nga tri grupe të ndryshme: persona udhëheqës të kopshteve, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe kujdestarë dhe përfaqësues të shërbimeve profesionale të kopshteve. Përzgjedhja e pjesëmarrësve në fokus grupet u bë nga ekipi hulumtues, në konsultim me Avokatin e Popullit dhe UNICEF-in, dhe u bënë përpjekje për të siguruar përfaqësim adekuat sipas disa karakteristikave të ndryshme.

Në fokus grupet me personat udhëheqës të kopshteve kishte gjashtë të anketuar, të gjithë femra. Pesë nga ato, para se të vijnë në pozitën udhëheqëse, kanë punuar si kujdestare dhe kanë shumë vjet përvojë nga kjo fushë. Njëra prej të anketuarve, para që të vijë në pozitën e drejtores, ka punuar si juriste në kopsht. Pesë të anketuar ishin nga Rajoni i Shkupit, kurse një e anketuar ishte nga Rajoni Lindor. Në periudhën e zbatimit të fokus grupeve ishte më vështirë të sigurohet të anketuar në këtë grup për shkak të pushimeve dhe për shkak të tendencës për ndryshime të personave udhëheqëse.

**Grupi i dytë ishte me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, i cili përfshinte tetë të anketuar, krejt femra.**

Pesë nga të anketuarit ishin nëna e fëmijëve që përballohen me autizëm dhe spektër autik të çrregullimeve, një ishte nëna e fëmijë me përkufizim të kombinuar (kufizime fizike dhe dëmtime shikimi), një ishte nëna e fëmijë me kufizim intelektual (Sindromi Down), dhe një pjesëmarrëse ishte nëna e fëmijës me kufizim të kombinuar që është pasojë prej një sindromë të rrallë.

Pesë prindër të përfshirë në këtë fokus grup kanë fëmijë që për momentin janë përfshirë në kopsht, kurse tre prindër janë me fëmijë që para kohe të shkurtër janë regjistruar në arsim (dy fëmijë në shkollë speciale, dhe një nga fëmijët në shkollën e rregullt).

Gjashtë nga të anketuarit ishin nga Rajoni i Shkupit; një nga Rajoni e Vardarit dhe një nga Rajoni Lindor.

**Fokus grupet me kujdestarë dhe përfaqësues të shërbimeve profesionale** përfshiu 25 të anketuar në dy grupe, me që,

24 të anketuar ishin femra dhe një mashkull. Nga pikëpamja e profilit profesional, 14 prej tyre punuan si bashkëpunëtor profesionalë –

tetë defektologë, dy logopedë dhe numri i njëjtë i pedagogëve dhe psikologëve, ndërsa të tjerët 11 të anketuar ishin kujdestarë.

Nëntë prej të anketuarve ishin nga Rajoni i Shkupit, tre nga Rajoni Lindor, pesë nga Rajoni i Vardarit, dy nga Rajoni i Pellagonisë, dy nga Rajoni i Pollogut, dhe nga dy të anketuar nga Rajoni Verilindor dhe Juglindor.

Vijon pasqyra tabelare e pjesëmarrësve në fokus grupet sipas parametrave të caktuara:

Rajon planor	SH	L	VL	VR	PE	PO	JL	Gjithsej
Numri i pjesëmarrësve në fokus grupet	20	5	2	6	2	2	2	<b>39</b>

**PASQYRA 4: Numri i pjesëmarrësve në fokus grupet sipas rajoneve planore<sup>6</sup>**

Grupi qëllimor	PU	PR	KU	PE	PS	DE	LO	Gjithsej
Numri i pjesëmarrësve në fokus grupet	6	8	11	2	2	8	2	<b>39</b>

**PASQYRA 5: Numri i pjesëmarrësve në fokus grupet sipas grupeve qëllimore<sup>7</sup>**

<sup>6</sup> SH-Rajoni i Shkupit; L- lindor; VL-verilindor; RV-Rajoni i Vardarit; PE-Rajoni i Pellagonisë; PO-Rajoni i Pollogut; JL-juglindor

<sup>7</sup> PU-Personat udhëheqës; PR- prindër; KU- kujdestarë; PE- pedagogë; PS-psikologë; DE- defektologë; LO- logopedë





# METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

## METODAT E HULUMTIMIT

Hulumtimi ishte zbatuar nëpërmjet metodave: hulumtim nga zyra, anketa, intervista dhe fokus grupi.

Hulumtimi nga zyra përfshiu rishqyrtim të kornizës ligjore dhe politikave publike të cilat i përkasin përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor. Pika fillestare në analizën ishin dispozitat dhe standardet e dhëna nga Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe shkallën e harmonizimit të kuadrit ligjor kombëtar me këto dy dokumente. Lista e dokumenteve të përfshira në hulumtim është dhënë në Shtojcën 1.

Në institucionet parashkollore u zbatua [anketë](#) në lidhje me të kuptuarin e tyre, përvojat (praktikat) dhe qëndrimet (si institucion) lidhur me përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Për anketën u përgatit një pyetësor, me një kombinim të pyetjeve të mbyllura, gjysmë të hapura dhe të hapura, të bashkangjitura në Shtojcën 2.

Janë zbatuar intervista gjysmë të strukturuar me personat përgjegjës nga 16 kopshte nga të gjitha rajone planore të vendit. Intervistat u bënë në vetë kopshtet dhe na mundësuan që të marrim informata dhe sqarime më të hollësishme rreth kuptimeve, përvojave dhe qëndrimeve të kopshteve në lidhje me inkluzionin (për që paraprakisht u morën informacione përmes anketës). Pyetjet e përdorura në intervistat janë të bashkangjitura në Shtojcën 3.

Nëpërmjet **fokus grupeve** janë përfshirë katër kategori të të anketuarve: personat udhëheqës nga kopshtet, kujdestarët, përfaqësues të shërbimeve profesionale në kopshtet, dhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Vëmendja u fokusua në identifikimin e përvojave të të anketuarve dhe sfidat, nevojat dhe mënyrat e mundshme për të forcuar edhe më tej gjithëpërfshirjen në arsimin e mesëm. Çështjet e adresuara në fokus grupet janë të bashkangjitura në Shtojcën 4.

## KORNIZA KOHORE

Hulumtimi u zbatua në periudhën maj – korrik të vitit 2018, sipas dinamikës së mëposhtme:

- ▶ hulumtim nga zyra: maj – korrik;
- ▶ hulumtim me anketa: maj- qershor;
- ▶ vizita në shkolla dhe intervista me përfaqësuesit e shkollave: qershor- korrik; dhe
- ▶ fokus grupet: korrik.

Pas përpunimit të të dhënave të grumbulluara, raporti i studimit u finalizua në gusht të vitit 2018.





INKLUZIONI  
I FËMIJËVE ME  
AFTËSI TË KUFIZUARA  
NË INSTITUCIONET  
PARASHKOLLORE -  
KOPSHTET E FËMIJËVE



## ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE

Korniza ligjore ndërkombëtare dhe standardet në fushën e arsimit gjithëpërfshirës janë përcaktuar nga: Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar<sup>8</sup> (KDKPAK), Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF)<sup>9</sup> dhe Deklarata e UNESCO-s për arsim të bazuar mbi nevojat e posaçme nga Salamanka (më tutje: Deklarata e Salamankës<sup>10</sup>). Konventat janë ratifikuar nga Republika e Maqedonisë, meqenëse dispozitat e tyre janë pjesë e rendit juridik të shtetit. Te ne, arsimi parashkollor tashmë nuk është formalizuar dhe nuk është ngritur në nivel të një arsimit.

Këto dokumente bazohen në pikëpamjen se çdo fëmijë ka nevoja individuale. Prandaj, vetëm zbatimi i qasjes së individualizuar për arsimin mundëson që të zhvillohen maksimalisht potencialet dhe të ofrohen mundësi të barabarta arsimore për të gjithë fëmijët. Qasja e individualizuar do të thotë se sistemi arsimor ka nevojë për të përshtatur të gjithë procesin e mësimdhënies dhe të mësuarit me nevojat dhe aftësitë e secilit fëmijë. Për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në procesin arsimor, fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për mbështetje individuale.

KDKPAK në nenin 7 obligon shtetet që të sigurojnë të gjitha të drejtat e njeriut në mënyrë të barabartë me të gjithë fëmijët e tjerë". Vendimmarrja duhet të bazohet në "interesin më të mirë të fëmijës". Neni 9 siguron qasje në personat me aftësi të kufizuara në mënyrë të barabartë me të tjerët", ndër të tjera, për shkollat, qasje në informacione të ndryshme, internetin dhe teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit. Neni 24 i KPAK-së i referohet në mënyrë specifike arsimit, duke i detyruar shtetet "të mos përjashtojnë në bazë të aftësisë së kufizuar" fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara nga sistemi i përgjithshëm arsimor". Shtetet janë të detyruara të ofrojnë "përshtatje të arsyeshme ndaj nevojave individuale" dhe "mbështetje efektive individuale" për fëmijët me aftësi të kufizuara "brenda sistemit të arsimit të

<sup>8</sup> Shiko: Ibid1

<sup>9</sup> Shiko: Konventa për të Drejtat e Fëmijës, gjendet në [https://www.unicef.org/tfyrmacedonia/CRC\\_albanian\\_language\\_version\(3\).pdf](https://www.unicef.org/tfyrmacedonia/CRC_albanian_language_version(3).pdf)

<sup>10</sup> Shiko: Deklarata e UNESCO-s për arsim të bazuar mbi nevojat e posaçme nga Salamanka (Deklarata e Salamankës), gjendet në [https://www.unesco.de/fileadmin/medien/Dokumente/Bildung/Salamanca\\_Declaration.pdf](https://www.unesco.de/fileadmin/medien/Dokumente/Bildung/Salamanca_Declaration.pdf)

përgjithshëm". Mësimi duhet të bëhet në "gjuhët më të përshtatshme, në mënyra dhe me mjete më të përshtatshme për komunikim me çdo individ", duke përmendur, ndër të tjera, Brill dhe gjuhën e shenjave. I njëjti nen i detyron shtetet të trajtojnë dhe aftësojnë mësuesit për të ofruar mbështetje individuale për nxënësit me aftësi të kufizuara "duke përfshirë mësuesit me aftësi të kufizuara". Duhet të theksohet se neni 31 i fton shtetet palë të "mbledhin informacionin e duhur, duke përfshirë të dhënat statistikore dhe hulumtuese, në mënyrë që të sigurohet formulimi dhe zbatimi i politikave për zbatimin e kësaj Konvente".

Deklarata e Salamankës parashikon se fëmijët me aftësi të kufizuara "duhet të kenë qasje në shkolla të rregullta të cilat duhet të plotësojnë nevojat e tyre duke aplikuar qasjen pedagogjike që synon fëmijët." Deklarata thekson se përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në arsimin e përgjithshëm duhet të jetë zakon, jo përjashtim: "Një parim themelor i shkollës gjithëpërfshirëse është që të gjithë fëmijët duhet të mësojnë së bashku, kudo që të jetë e mundur, pavarësisht vështirësive dhe diversitetit që mund të ekzistojnë".

Në KDF, fëmijëve me aftësi të kufizuara u është dedikuar neni 23, i cili parashikon se një fëmijë me aftësi të kufizuara intelektuale ose fizike duhet të bëjë një jetë normale dhe me dinjitet, në kushte që garantojnë dinjitetin, nxisin pavarësinë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen aktive të fëmijës në komunitet". I njëjti artikull njeh "të drejtën" e fëmijëve me aftësi të kufizuara për "kujdes të veçantë" dhe, ndër të tjera, "qasje efektive në arsim, trajnim, përgatitje për integrim shoqëror dhe zhvillim personal sa më të plotë të jetë e mundur".

Dokumenti kryesor nga fusha e arsimit parashkollor në vendin tonë është Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve<sup>11</sup>:

<sup>11</sup> Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve (Tekst i konsoliduar të Ligjit i përfshin: Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/13; Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/14); Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.44/14); Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.144/14); Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 10/15); Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 25/15) dhe Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/15), në të cilin është shënuar koha e hyrjes së tyre në fuqi.

Në zbatimin e dispozitave të këtij ligji, niset nga parimet e mbrojtjes së të drejtës për jetë dhe zhvillimit të fëmijës, mbrojtjes së interesave më të mira të fëmijës, sigurimit të një standardi minimal për çdo fëmijë nën kushte të barabarta, përjashtimit të çdo forme diskriminimi, respektimit të të drejtës së fëmijës për liri dhe siguri të personalitetit të tij, për mendim dhe shprehjen e lirë, për shoqërim dhe arsim, për kushte për një jetë të shëndetshme dhe ushtrim të të drejtave dhe lirive të tjera shoqërore të fëmijës (neni 4).

Sipas nenit 11, paragrafi 1 prej këtij ligji, çdo fëmijë, në kuptimin e këtij ligji, konsiderohet çdo person derisa nuk mbushet 18 vjet, si dhe “persona me pengesa në zhvillimin trupor dhe mendor derisa nuk mbushen 26 vjet”. Ky ligj e parandalon diskriminimin në bazë të përkufizimit, por e definon si paaftësi (nen 12, paragrafi 1): „Ndalohet çdo formë e diskriminimit në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, qëndrimet politike apo tjetër, prejardhja kombëtare, etnike ose shoqërore, përkatësisë kulturore ose e tjerë, statusit të pronës, **paaftësisë**, lindjes ose ndonjë statusi tjetër të fëmijës, prindit ose kujdestarit të tij ligjor“.

Neni 54 i Ligjit përcakton se kujdesi dhe edukimi i fëmijëve në moshën parashkollore është një formë e mbrojtjes së fëmijëve që organizohet si një aktivitet për kujdes, qëndrim, ushqim, aktivitete arsimore-rekreative, aktivitete kulturore dhe argëtuese, masa dhe veprime për të përmirësuar dhe për të ruajtur shëndetin dhe për të nxitur zhvillimin intelektual, emocional, fizik, mendor dhe shoqëror të fëmijës deri në moshën gjashtëvjeçare, domethënë deri në përfshirjen në arsimin fillor.

Neni 60, paragrafi 1, parashikon të drejtën e regjistrimit në kopshtin në bazë të kërkesave gjatë gjithë vitit; paragrafi 8, nga ana tjetër, siguron detyrimin për prindërit gjatë regjistrimit të fëmijës në kopsht të paraqesin vërtetim nga mjeku i përgjithshëm për gjendjen shëndetësore të fëmijës, ose “gjetja dhe mendimin e institucionit përkatës profesional për fëmijët me aftësi të kufizuara mendore ose trupore.”

Përveç kësaj, neni 64, paragrafi 2, përcakton normat për numrin e fëmijëve nëpër grupe sipas moshës, me që përcaktohet se puna në kopshtin është i organizuar në përputhje me moshën e fëmijëve në grupe homogjene, si është dhënë në vijim:

1	deri në 12 muaj	▶	nga gjashtë deri në tetë fëmijë;
2	nga 12 deri në 18 muaj	▶	nga tetë deri në dhjetë fëmijë;
3	nga 18 muaj deri në dy vjet	▶	nga dhjetë deri në 12 fëmijë;
4	nga dy deri në tre vjet	▶	nga 12 deri në 15 fëmijë;
5	nga tre deri në katër vjet	▶	nga 15 deri në 18 fëmijë;
6	nga katër deri në pesë vjet	▶	nga 18 deri në 20 fëmijë, dhe
7	nga pesë deri në gjashtë vjet	▶	nga 20 deri në 25 fëmijë

(3) Si përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, varësisht nga mosha e fëmijëve, mundet të organizohet:

### 1 GRUPI HETEROGJEN

deri në dy vjet



nga dhjetë deri në 12 fëmijë dhe

nga dy vjet deri në përfshirjen në arsimin fillor



nga 18 deri në 20 fëmijë;

### 2 GRUP I KOMBINUAR

nga 12 muaj deri në përfshirjen në arsimin fillor



nga 15 deri në 20 fëmijë;

### 3 GRUPI I FËMIJËVE ME PENGESA NË ZHVILLIM

nga pesë deri në tetë fëmijë dhe

### 4 GRUP I FËMIJËVE NGA GJASHTË VJET

domethënë deri në përfshirjen në arsimin fillor deri në dhjetë vjet



nga 20 deri në 30 fëmijë“.

Kur këto dy dispozita do të shihet së bashku është e qartë se prindi është përgjegjës për fëmijën e tyre me aftësi të kufizuara të sigurojë dokumentacionin e duhur për llojin dhe shkallën e kufizimit për regjistrim në kopshtin e fëmijëve, dhe kopshti është i obliguar që të sigurojë kushtet dhe normat e duhura që kryesisht i referohen numrit të fëmijëve në grupet. Ligji ofron mundësi që në kuadër të kopshtit të formohet një grup për fëmijët me aftësi të kufizuara, por kjo dispozitë aspak nuk është në drejtim të gjithëpërfshirjes, dhe nënkupton vetëm integrimin fizik. Përveç kësaj, paragrafi 4 i të njëjtit nen përcakton: në grupet mund të kyçet nga një fëmijë me aftësi të kufizuara të lehta mendore ose trupore, në të cilin rast numri i fëmijëve në grupe është reduktuar për dy fëmijë.”

Neni 65 është kushtuar veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe në të njëjtin nen është përcaktuar se: Kopshtet organizojnë kujdesin dhe edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore ose aftësi të kufizuara fizike, në përputhje me llojin dhe shkallën e kufizimit të tyre. Në përkufizimin e termave të tilla, si fëmijët me aftësi të kufizuara mendore ose aftësi të kufizuara fizike konsiderohen fëmijët e verbër dhe personat pjesërisht të verbër, të shurdhër, fëmijët me vështirësi në të folur, fëmijët me aftësi të kufizuara fizike, dhe fëmijët me vështirësi në sjellje dhe personalitet (paragrafi 2 ). Në këtë definicion, kategoritë dhe vështirësitë në sjelljen dhe personalitetin e fëmijës nuk janë specifikuar dhe prandaj ekziston mundësi për interpretim të ndryshëm, d.m.th. mbulojnë një kategori të gjerë fëmijësh. Sipas paragrafit 3 të këtij neni, kujdesi dhe edukimi e fëmijëve me aftësi të kufizuara të lehta në zhvillimin mendor dhe aftësi të kufizuara fizike nga ky nen, që kanë nevojë për zbatim të përshtatur të programeve, organizohet brenda grupeve të rregullta. Ndërsa, sipas paragrafit 4, kujdesi dhe edukimi e fëmijëve me aftësi të kufizuara të mesme në zhvillimin mendor ose fizik nga paragrafi (2) i këtij neni, zbatohet në grupe të veçanta, sipas programeve të veçanta. Përsëri, ekziston një dispozitë në ligjin që nuk ka karakter përfshirës, që nënkupton ndarjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara të mesme në zhvillimin mendor dhe fizik në grupe të veçanta.

Neni 136 përcakton se defektologu, logopedi, pedagogu, psikologu, punëtori i punëve shoqërore dhe shëndetësore janë pjesë e “bashkëpunëtorëve profesionale” në kopshtet dhe ofrojnë mbështetje për kuadrin edukativo-kujdestar.

Ministra e Punës dhe Politikës Sociale, në bazë të këtij ligji, ka miratuar **Rregulloren për standarde dhe norma për punën e institucioneve për fëmijë**.<sup>12</sup> Neni 6 i kësaj Rregulloreje e definojnë qasjen deri në objektin të kopshtit si qasje ose hyrje me shtigje këmbësore, hapësirë për parking dhe oborr, me që:

- ▶ shtigjet këmbësore- shërbejnë për të kapërcyer distancën midis rrugës dhe hyrjen e ndërtesës dhe ata duhet të jenë të sigurt dhe të mbrojtur, shtruar apo të asfaltuar, të mos jenë të rrëshqitshëm dhe të jenë të rregulluar me hortikulturë.
- ▶ zona e parkimit shërben për qasje me automjete dhe nuk duhet të ndërhyjë në aktivitetet e rregullt të fëmijëve.

Në dallim të përkufizimit të qasjes në objektin, në këtë nen nuk është ofruar një përkufizim i aksueshmërisë së objekteve, edhe pse kjo është një kërkesë e rëndësishme. Përveç kësaj, neni 20, paragrafi 3, përcakton se hyrja e objektit dhe qasje në dhomat për fëmijët duhet të jenë pa pengesa arkitekturore, dhe sipas paragrafit 10, këndi maksimal i rampave hyrëse duhet të jetë në 1:12 (8.33 %). Paragrafi 11 rekomandohet instalimi i një ashensor, me dimensionet e kabinës 100/130 cm në qoftë se objekti i kopshtit ka më shumë se një kat.

Neni 18 i Rregullores parashikon që kopshti mund (që do të thotë se nuk është i detyruar) të sigurojë hapësirë për punë individuale me fëmijët që kanë nevojë për këshillim ose ndihmë me hapësirë minimale prej 8 m<sup>2</sup>. Dhoma e paragrafit (1) të këtij neni mund të përdoret për këshillimin e fëmijëve dhe prindërve.

Në lidhje me pajisjet e kopshtit, Neni 43 përcakton për fëmijët me aftësi të kufizuara, pajisja në dhomat ku janë përkujdesur ata, të jetë e përshtatur dhe plotësuar në mënyrë të përshtatshme. Rregullorja gjithashtu përcakton materialet e nevojshme didaktike dhe materialet mësimore, në përputhje me moshën e fëmijëve.

Më tej u shqyrtua edhe dokumenti Vlerësimi i suksesit të aktiviteteve të planifikuara të planit zhvillimor<sup>13</sup>, publikuar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, e cila përcakton kornizën për vlerësimin e të gjitha aspektet e punës së një kopshti. Vlefshmëria e suksesit të institucionit kryhet në çdo fushë kyçe dhe shprehet numerikisht dhe me përshkrim.

<sup>12</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 28 me datën 06.02.2014

<sup>13</sup> [http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/vrednuvanje\\_2017.pdf](http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/vrednuvanje_2017.pdf) vizituar me datën 20.07.2018

Suksesi i aktiviteteve të planifikuara nga plani i zhvillimit të institucionit vlerësohet në fushat kyçe. Fushat kryesore janë treguesit kryesorë të punës së institucionit. Çdo fushë kryesore është e ndarë në fusha të vlerësimit si tema më të ngushta. Fushat e vlerësimit përfshijnë tregues që përcaktojnë më saktësisht punën dhe aktivitetet e institucioneve për fëmijët.




**GJETJET KRYESORE  
NGA HULUMTIMI  
NË TERREN**



## PËRFAQËSIMI I FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË ARSIMIN PARASHKOLLOR

Nga analiza e të dhënave të pyetësorëve të dorëzuar nga 58 kopshtet e fëmijëve, del se në vitin e kaluar dhe në vitin e tanishëm, në 39 kopshte (ose 68%) ka fëmijë me aftësi të kufizuara. Numri total i nxënësve me aftësi të kufizuara në kopshtet është 415.



### **PASQYRA 6:** Kopshte dhe me pa fëmijë me aftësi të kufizuara


Gjatë analizës, nëse merren parasysh vetëm kopshtet që kanë raportuar se kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, mesatarja është 10,64 fëmijë në kopsht, ose, nga numri gjithsej i fëmijëve të regjistruara në kopshtet, i cili është 34.700 fëmijë, përqindja e fëmijëve me aftësi të kufizuara është 1,19%.

Analiza e kombinuar e të dhënave tregon se 36% nga fëmijët e regjistruar janë përfshirë në kopshte në Rajonin e Shkupit, ndërsa 64% në kopshte në rajonet e tjera. Hulumtimi nuk është dizajnuar që të përcaktojë se nga rrjedh ky dallim, por një nga supozimet e mundshme është se ai bazohet në lokacionin e kopshteve, për faktin se pjesa më e madhe të kopshteve është në Rajonin e Shkupit.

Në qoftë se numri prej 415 fëmijës shqyrtohet më detajisht, sipas të dhënave të pyetësorit, pjesa më e madhe të këtyre fëmijëve janë me autizëm (104), dhe menjëherë vijnë edhe fëmijët me përkufizime intelektuale (101). Më pak ka fëmijë me pengesa në shikim (7 fëmijë). Prej kategorive të tjera kufizimesh, përmes pyetësorit të anketës, kopshtet kanë raportuar 70 fëmijë me përkufizime të kombinuar, 13 fëmijë me kufizime fizike dhe 42 fëmijë me dëmtime të dëgjimit dhe/ose të folurit në shkallë më të rëndë. Në pjesën “e tjerë” të pyetësorit, kopshtet kanë raportuar për fëmijë me zhvillim të ngadalë psikomotorik, Sindroma Daun, diabet dhe hiperaktivitet. Numri i këtyre fëmijëve është 78. Këto statistika nuk janë të përpikta dhe nëse grumbullohen numrat e kësaj analize, numri nuk do të çojë 415 fëmijë në gjithsej. Kjo tregon se kopshtet nuk kanë statistika të sakta, as nuk mbajnë shënime të sakta të llojit të kufizimit me të cilin përballet fëmija. Kjo, ndër të tjera, rrjedh nga gatishmëria e pamjaftueshme për këtë çështje, por edhe nga mungesa e dokumentacionit me të cilin konfirmohet aftësia e kufizuar. Ky përfundim u konfirmua gjatë vizitave në terren dhe fokus grupeve. Edhe pse kopshtet disponojnë me një numër të përgjithshëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara, ata nuk kanë të dhëna mbi numrin e fëmijëve sipas kategorive të kufizimeve të ndryshme.

Sipas të dhënave, zbulimi dhe, rrjedhimisht, evidentimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte fillon pas muajit të 18-të. Prandaj, sipas pyetësorit të anketës, numri më i madh i fëmijëve me aftësi të kufizuara zbulohet në grupin e madh, i cili mbulon fëmijë të moshës 5-6 vjeçare, dhe numri i tyre është 143. Në çerdhet nuk janë zbuluar fëmijë me aftësi të kufizuara.

Pyetjes nëse kopshti ka qenë në situatë të refuzojë një fëmijë me aftësi të kufizuara, 48 kopshte janë përgjigjur se “nuk ishin detyruar të refuzojnë” fëmijë me aftësi të kufizuara në regjistrimin, dhe 10 (17.2%) kopshte që u gjetën në situatën të tillë, arsytet për refuzimi i gjejnë në në grupet e mbipopulluara dhe mospërgatitja e kuadrit për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara, **“Për shkak të rritjes së numrit të fëmijëve në grupet, nuk ka mundësi për të pranuar fëmijëve shtese në përgjithësi, jo vetëm fëmijët me aftësi të kufizuara. Përveç kësaj, legjislacioni parashikon një reduktim prej 2 fëmijëve nga normat e përcaktuara në rastin e përfshirjes së një fëmije me aftësi të kufizuara, dhe kjo në praktikë nuk është e mundshme, për shkak se numri i fëmijëve në grupet është vazhdimisht mbi numrin e lejuar. Një problem tjetër me të cilin ballafaqohemi është mungesa e kuadrit të trajnuar, por edhe kuadrit të punësuar në mënyrë të rregullt.”**



**PASQYRA 7:** Përgjigjet e pyetjes “A ka ndodhur që kopshti juaj të mos ketë mundësi të pranojë ndonjë fëmijë me aftësi të kufizuara?”

Edhe pse shumica e kopshteve, 48 (82.8%) paraqitën se nuk kanë qenë në një situatë të refuzojnë një fëmijë me aftësi të kufizuara, gjithsesi gjatë vizitave në terren dhe grupeve të kryera fokus kemi gjetur shembuj ku kushtet në kopshtet i kanë detyruar prindërit të të heqin dorë dhe të gjejnë një alternativë tjetër për fëmijën e tyre: **“Fëmija im u regjistrua në kopsht kur kishte 2 vjet. Nuk kishim asnjë problem deri në moshën 2 vjeçare kur identifikua një problem në të folurit dhe në sjellje. Për ne ishte e rëndësishme që ajo të përfshihet në aktivitetet e kryera nga kopshti. Insistua. Një javë, gjatë aktiviteteve në natyrë, vura re se fëmija im rrinte anësh me një gjethe në duart e saj. E izoluar dhe vetëm. Ne kërkua të përfshinim një edukator special që do ta financonim atë nga fondet tona, por ata nuk na lejonin. Situata të tilla na detyruan ta regjistrujmë në një kopsht privat.”**

Gjatë vizitave në terren kemi hasur klimë dhe qëndrime pozitive ndaj pranimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Kopshtet theksuan se nuk është ndodhur që qëllimisht të refuzojnë një fëmijë me aftësi të kufizuara, vetëm që fëmijët do të vendosen në listën e pritjes, siç është rasti me të gjithë fëmijët për shkak të rritjen e numrit të grupeve dhe mungesës së kuadrit. Kjo çoi në përfundimin se ka mungesë të procedurave sistematike për regjistrimin, monitorimin dhe evidentimin e progresit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Regjistrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte nuk është i rregulluar. Më shpesh, regjistrimi kryhet nga prindi, pa fëmijën. Në kopshtet, gjatë regjistrimit,

nuk kryhen as testimet as vëzhgimet para se fëmija të përfshihet në grup. Prandaj, shërbimet profesionale nuk kanë informacion mbi aftësinë e kufizuar të fëmijës, dhe as dokumentacioni i vërtetë. Edukatori takon për herë të parë fëmijën kur përfshihet në një grup. Një përfaqësues i grupit të fokusit vuri në dukje: **“Këtë vit erdhi një fëmijë me një kufizim fizik. Komisioni ynë për regjistrim sugjeroi që fëmija do të jetë në gjendje të angazhohet në aktivitete dhe të sigurojmë qëndrim për atë në qoftë se arrijmë në institucion të sigurojmë një asistent personal. Dërguam një kërkesë deri në komunën dhe ende jemi duke pritur për përgjigje.”**


Gjatë një vizite në një kopsht në një mjedis rural, u konkludua se në disa mjedise ekziston mendimi se kopshtet nuk janë më të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. **“Në mjedisin tonë, në oborrin e kopshtit u ndërtua një qendër ditore për personat me aftësi të kufizuara. Deri më tani ende nuk ka filluar me punë, edhe pse është ndërtuar shumë kohë më parë. Prindërit shpresojnë se do të fillojë me punë dhe mendojnë se është më mirë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Prandaj, deri tani nuk na kanë afruar për pranimin e një fëmije me aftësi të kufizuara, “tha një drejtore e një kopshti një vizite në terren.**

Për shkak të mungesës së procedurave të qarta dhe të sakta për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte, në praktikë vërehen dallime midis kopshteve të ndryshme në lidhje me regjistrimin dhe pranimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara janë në praktikë. Kjo u konfirmua edhe nga prindërit gjatë diskutimeve në fokus grupin. Kështu, një prind tha: **“Ne u përpoqëm ta regjistrujmë fëmijën tonë në kopshtin në Draçevë, pranë shtëpisë sonë. Gjatë regjistrimit ata na thanë se nuk do të ishin në gjendje ta praninin atë. Menjëherë kishte një klimë negative. Për të shmangur atë që mendoam se do të ndodhë, vizituam një kopsht fëmijësh në Kisella Vodë, dhe aty menjëherë na pranuan pa asnjë problem. Kuadri ishte i sjellshëm dhe i këndshëm.”**

Një nga rekomandimet që doli nga grupet e fokusit në drejtim të përmirësimit të kësaj gjendjeje është të futet një regjistrim me konkurs, i cili do të zgjasë për një periudhë të caktuar gjatë vitit: **“Ne kemi nevojë për regjistrim me konkurs. Muajt e parë të shtyhet përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në mënyrë që fëmijët e tjerë të përshtaten dhe pastaj më vonë kur do të qetësohen, të përfshijmë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Edukatorët janë të hutuar, fëmijët qajnë nga çdo anë dhe në grup ata kanë edhe një fëmijë me aftësi të kufizuara “.**

Pasi do të përfshihet një fëmijë me aftësi të kufizuara në kopshtin e fëmijëve, vështirësia e parë më të cilën përballohen prindërit dhe kopshtet, është numri i madh i fëmijëve në grup, që tejkalon standardet e parashikuara. Gjatë anketës, por edhe gjatë vizitave në terren u diskutua rreth mundësisë dhe të drejtës për të siguruar kuadër shtesë në grupet me fëmijë me aftësi të kufizuara. Ne nuk gjetëm një përgjigje pozitive në favor të kësaj çështjeje. Deri më tani kuadër shtesë nuk është siguruar në asnjë kopsht fëmijësh, edhe pse kopshtet kanë kërkuar atë. Prandaj, gjatë vizitave në terren dhe gjatë fokus grupeve, të anketuarit theksuan nevojën për të ofruar asistentë personalë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Lidhur me rolin dhe detyrat e një asistenti personal, shpesh në fokus grupe deklaroi se asistenti personal do të jetë i nevojshëm për kryerjen e shprehive kulturore dhe higjienike të fëmijëve me aftësi të kufizuara (e zhveshjes, të ushqyerit, larje etj.).

Sipas pjesëmarrësve të fokus grupeve, rritja e numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte është një përvojë dhe sfidë me të cilën përballlet çdo kopsht. Ka shqetësime për numrin në rritje. Opinionet janë të ndara: disa besojnë se kjo është për shkak të faktit se gjithnjë e më shumë janë lindur fëmijë me aftësi të kufizuara, ndërsa të tjerët thanë: **“Ndërgjegjësimi i prindërve dhe anëtarëve të shërbimeve profesionale dhe edukatorëve është më i madh kur bëhet fjalë për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte. Jam e habitur që në faqen e internetit të Ministrisë ka një program të veçantë për punë me këta fëmijë. Kjo nuk është e nevojshme. Është e nevojshme që programin që e realizojmë të jetë me cilësi të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e të gjithë fëmijëve dhe për të siguruar një mjedis stimulues për zhvillim “.**



#### **PASQYRA 8: Përgjigjet e pyetjes “Në çmënyrë i identifikon kopshti juaj nxënësit me aftësi të kufizuara?”**

Procesi i zbulimit, identifikimit dhe regjistrimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara është i vështirësuar për shkak të mungesës së procedurave të unifikuara sistematike në lidhje me zbulimin e hershme dhe intervenimin. Nga ana tjetër, procesi është i vështirësuar edhe pse prindërit nuk janë të edukuar në këtë aspekt dhe nga mungesa e përkrahjes nga shërbime adekuate dhe drejtimi i veprimit i cili i nevojitet të pranojnë paaftësinë e fëmijës së tyre dhe të reagojnë në mënyrë të përshtatshme, si dhe mungesa e kompetencave të shërbimeve profesionale dhe të kuadrit edukativo-kujdestarë për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara. Këto të dhëna konfirmohen edhe nga vizitat në terren dhe nga fokus grupet. Bashkëbiseduesit në kopshtet theksojnë se gjatë përcaktimi të kufizimit të fëmijëve përdorin disa mënyra: Për fëmijët ku ka kufizime të dukshme, kufizime fizike, probleme me shikimin ose të dëgjuarit, prindërit paraqesin dokumentacionin që në procesin e regjistrimit të fëmijës. Për disa fëmijë që kanë kufizime, kujdestari zakonisht është i pari që e dallon kufizimin dhe e njofton shërbimin profesional dhe/ ose e ftuan prindin për një bisedë. Gjatë vizitave në terren dhe grupeve të fokusit, punonjësit e kopshteve theksuan se kishin vështirësi me dokumentet që morën nga mjekët e përgjithshëm. Për shembull, kopshti merr një dokument ku thuhet se

fëmija ka një zhvillim të rregullt. Edukatorët dhe shërbimi profesional vunë re se ka ndonjë përkufizim. Në komunikim me mjekun, më vonë kuptuan se ai nuk e kishte kontrolluar fëmijën fare. Ka situata kur dokumenti dhe pohimi i prindit janë kontradiktore, për shembull, prindi njofton se fëmija ka pengesa në shikim, dhe kjo nuk është shënuar në dokumentacionin. Më tutje, kopshtet kanë vështirësi të bindin prindërit të sigurojnë dokumentacion, sepse ligji nuk i obligon. Prandaj, ka dallime në identifikimin dhe regjistrimin e numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara midis kopshteve të ndryshme: **“Në grupin tim ka 27 fëmijë, nga të cilët një fëmijë është me aftësi të kufizuara. Bashkëpunimi është i vështirë me prindin i cili më thotë: ‘Unë nuk do t’ju dërgoj një dokument në asnjë mënyrë.’ Ne jemi të detyruar si institucion, kur inspektorët vijnë nga jashtë, të kemi notim dhe vlerësim të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Nga 25 fëmijët e kopshtit tonë, për të cilën ekipi ka vlerësuar se kanë aftësi të kufizuar, vetëm dy prindër kanë paraqitur dokumente. E çfarë me të tjerët? Megjithatë, me ta ne duhet të punojmë në mënyrë të ndryshme dhe individualisht”** - u shprehën përfaqësuesit e fokus grupeve.

Kjo shoqërohet me faktin se edhe pse prindërit kanë mundësi në dosjen që e plotësojnë për fëmijën e tyre të shënojnë nëse ai/ajo ka ndonjë vështirësi, ata rrallë e shënojnë vështirësi: më shpesh në situata kur bëhet fjalë për ndonjë kufizim të dukshëm dhe në situata kur ka vështirësi me të folurit. Nga njëra anë, kjo është për shkak të mospranimin të situatës, por edhe nga fakti se mosha kur fëmijët regjistrohen në kopsht nganjëherë është kufizuese për “diagnostikim të problemit.”

Sipas informatave nga vizitat në terren dhe fokus grupet: prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk dorëzojnë dokumentacionin, mohojnë se ka një vështirësi dhe në shumicën e rasteve nuk janë bashkëpunues. Kopshtet thonë se, nga kjo pikëpamje, ligji nuk është në anën e tyre: **“Pse, nëse kopshti ka një ekip të plotë profesional, duhet të presim vërtetimin nga Instituti i Shëndetit Mendor, i cili kurrë nuk arrin te ne. A duhet të jemi me duar të lidhura vetëm për shkak se nuk kemi vërtetim, edhe pse ekipi ynë është profesional dhe ka vlerësuar se ndonjë fëmijë ka kufizime të caktuara”. “Prindërit duhet të sjellin dokumentin vetëm nëse fëmija duhet të qëndrojë edhe një vit shtesë në kopshtin, por edhe kjo nuk është gjithmonë detyrim.”**

Mënyrat dhe qasjet e ndryshme në identifikimin e numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara i shkaktojnë dallimet dhe lëshimet në evidencën

e dhënë në pyetësonin anketues gjatë vizitave në terren. Lëshimet e tilla bazohen ndodhin për këto arsye: në pyetësonin anketues janë paraqitur fëmijë për të cilët kopshti ka dokument relevant i cili e vërteton aftësinë e kufizuar dhe fëmijët e paraqitur janë fëmijë me aftësi të kufizuara në raste përkatësisht kopshte ku ka ekip profesional i cili ka vërtetuar se bëhet fjalë për aftësi të kufizuara. Gjatë vizitave në terren në katër kopshte, nga 16 gjithsej, janë vënë re dallime në numrin e paraqitur të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Dallimet ndodhin për shkak të dokumentacionit të padorëzuar me të cilin vërtetohen vështirësitë të fëmijët. Kopshtet kanë “frikë” të paraqitit fëmijë të cilët nuk kanë dokumentacion. Mandej, ekzistojnë kopshte ku nuk ka ekipet profesionale, kurse edukatorët kanë vënë re se fëmijët kanë vështirësi. Këta fëmijë nuk janë paraqitur në pyetësonin anketues, por gjatë vizitave në terren kopshtet i arsyetuan shkaqet për vendimin e tyre që të mos i evidentojnë fëmijët në pyetësonin anketues. Është interesante, por edhe shqetësuese e dhëna se në kopshte ka një numër të madh fëmijësh me vështirësi në të folur. Këta fëmijë nuk janë paraqitur në pyetësonët anketues. Informacione është marrë gjatë vizitave në terren. Bëhet fjalë për fëmijë të cilët kanë vështirësi në artikullimin e tingujve të caktuar. Këta fëmijë janë paraqitur edhe nga kopshtet ku ka logoped, por edhe nga kopshtet të cilat nuk kanë shërbim profesional. Këta fëmijë janë evidentuar në grupet e mëdha, në moshë nga 4 deri në 6 vjet. Një pjesë e kopshteve të vizituar theksuan se mesatarisht kanë nga 50 fëmijë me vështirësi në të folur vetëm në grupet e mëdha. Ekziston shqetësimi të edukatorët edhe për shkak të lidhjes së madhe, të fëmijëve, që në moshë të hershme me teknologjitë dhe përvetësimin e anglishtes para gjuhës amtare. Këtë vështirësi e theksuan të gjithë bashkëbiseduesit gjatë vizitave në terren dhe të anketuarit konsiderojnë se ky është vetëm një nga faktorët për zhvillimin e vonshëm të të folurit, por edhe për vështirësitë në të folurin.

Nga hulumtimi anketues 32% (19) e kopshteve theksuan se nuk kanë fëmijë me aftësi të kufizuar. Gjatë vizitave në terren janë vizituar edhe kopshte të cilat nuk kanë paraqitur fëmijë me aftësi të kufizuara në pyetësonin anketues. Nga pesë kopshte të vizituara të cilat në pyetësonin anketues nuk kishin paraqitur fëmijë me aftësi të kufizuara, katër paraqitën fëmijë me aftësi të kufizuar gjatë vizitave në terren. Kopshti i cili nuk paraqiti fëmijë është i vendosur në një mjedis rural. Relativisht i ri, i ndërtuar në një lokacion jo shumë të qashtëm, në afërsi të Qendrës ditore për personat me aftësi të kufizuara. Shkaqet pse deri më tani nuk ka fëmijë me aftësi të kufizuara është besimi se Qendra ditore do të fillojë me punë. Katër të tjerët janë kopshte




ku ka fëmijë me aftësi të kufizuar për të cilët institucionet nuk kanë dokumentacion të dorëzuar nga prindërit, kurse ekipi ka vënë re se fëmijët kanë aftësi të kufizuara. Një nga kopshtet nuk ka shërbim profesional, kurse edukatorët në vizitat në terren theksuan se kanë më tepër fëmijë me vështirësi më specifike në të folur. Bëhet fjalë për një mjedis ku nuk asnjë lloj shërbimesh për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar. Deri para tri ditësh kanë pasur mbështetje nga logopedët, e punësuar në Institutin për Dëgjim, të Folur dhe Tingull. I kanë vizituar një herë në muaj, me qëllim që të bëjnë vlerësim dhe të zbatojnë punë individuale me fëmijët të cilët kanë vështirësi me të folurin, por tashmë nuk e kanë këtë mbështetje. Vendi është relativisht larg qytetit dhe ata thonë: **“Ne kemi shumë fëmijë me vështirësi në të folur. Logopedët nuk na vizitojnë më. Këtu kemi logoped në afërsi. Prindërit kanë shpenzime nëse i çojnë në qytet, nuk ka mundësi t’i çojë çdokush.”** Kjo dukuri ilustron mungesën e kushteve themelore në nivel lokal, përveç mungesës së shërbimit profesional në kopsht, që e vështirëson dhe e komplikon edhe më tepër gjendjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar si edhe të familjeve të tyre.

Vizitat në terren dhe fokus grupet e zbatuara, prej të cilave janë marrë të dhëna cilësore, mundësuan numrat e marrë të vendosen në kontekst dhe të merret një pamje e qartë mbi numrin, por edhe qëndrimet dhe paragjykimet në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara në kopsht. Ekziston një kundërshtim i fshehur në lidhje me këtë pyetje, që është pasojë e paragjytimeve, mosinformimit dhe frikës nga e panjohura, kur përfshihen fëmijët me aftësi të kufizuara në grupe. Gjatë vizitave në terren një kopsht deklaroi se nuk do të pranonte fëmijë me epilepsi për shkak të përvojës së pakëndshme me kolegen: **“Nuk është aspak e thjeshtë, para disa vjetësh kishim një kolege e cila nuk na tregoi se ka epilepsi, kurse na ndodhi të bjerë në tualet, por e akuzoi kopshtin se ka qenë dyshemeja e lagur dhe nuk pranoi se ka një gjendje të cilën duhet ta dimë.”** Përvoja e tilla ka krijuar një ndjenjë të pakëndshme, por edhe qëndrim negativ në lidhje me këtë pyetje.

Në pyetëtorin anketues, kopshtet kishin mundësi t’i përgjigjen pyetjes se sa të hapur janë prindërit në komunikimin e vet, përkatësisht a e paraqesin aftësinë e kufizuar të fëmijës së vet gjatë regjistrimit në kopsht. Rezultatet e pyetëtorit anketues, pas përpunimit të të dhënave, janë kontradiktore. Domethënë, kanë pasur mundësi të përzgjedhin më shumë opsione për përgjigje. Për pyetjen se si kopshti e identifikon aftësinë e kufizuar të fëmijët, përgjigja më e shpeshtë me 65,3% është ajo ku kopshtet thonë se prindërit kanë dorëzuar në

shqyrtim dokumentacionin përkatës për aftësinë e kufizuar të fëmijës së vet. Mandej, për pyetjen në vijim, se si e paraqesin prindërit aftësinë e kufizuar të fëmijës së vet në kopshte, përgjigja më e shpeshtë, me 59,2% është se prindërit për një numër të vogël rastesh kanë dorëzuar dokumentacionin përkatës për aftësinë e kufizuar të fëmijës së vet. Këto pyetje kanë qenë njëra pas tjetrës në pyetësorin anketues dhe kontradikta i përgjigjeve ishte i dukshëm gjatë shqyrtimit dhe përpunimit të të dhënave. Në rastin e para del se kopshtet më shpesh, gjatë identifikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar bazohen në dokumentacionin e dorëzuar nga prindi, kurse përgjigja e marrë për pyetjen në vijim tregon problemin se prindërit nuk dorëzojnë dokumentacion, përkatësisht se vetëm një pjesë e vogël e prindërve dorëzon dokumentacion. Kjo kontradiktë ndodh për shkak se gjatë paraqitjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar në këtë pyetësor anketues, kopshtet i kanë paraqitur fëmijët për të cilët kanë dokumentacion të dorëzuar, prandaj thonë se më shpesh identifikimin e bëjnë në bazë të dokumentacionit të dorëzuar. Nga ana tjetër, është i madh numri i fëmijëve për të cilët nuk kanë dokumentacion, kurse vënë re se kanë aftësi të kufizuar, por nuk kanë mënyra si t'i obligojnë prindërit që të dorëzojnë dokumentacion. Mandej, institucionet të cilat e ndjekin punën në kopshte, kur kërkojnë prej tyre informacione për fëmijët me aftësi të kufizuar, kërkojnë që të përfshihen vetëm fëmijët të cilët kanë dokumentacion se kanë aftësi të kufizuar.


Vizitat në terren dhe fokus grupet treguan se dallimet individuale midis prindërve varen nga lloji i aftësisë së fëmijës, por edhe nga pranimi i gjendjes. Në përgjithësi, ekzistojnë vështirësi në sigurimin dhe dorëzimin e dokumentacionit përkatës në kopshte dhe për këtë arsye një prej bashkëbiseduesve thotë: **“Na nevojitet strategji, duhet të ketë sistem i cili që në fillim do ta japë gjendjen reale të fëmijës, gjithçka duhet të fillojë nga mjeku amë i cili duhet ta dërgojë prindin te ndonjëri nga entet dhe pastaj prindi në kopsht të vijë me dokumentacion i cili duhet të na i japë mundësitë funksionale të fëmijës dhe ne të fillojmë menjëherë nga puna pa improvizime.”** Për situatat e tilla, sipas deklaratave të marra gjatë vizitave në terren dhe gjatë fokus-grupeve, një interpretim i mundshëm është se midis prindërve, në përgjithësi, ekziston një vetëdije e pamjaftueshme si dhe mospranim i gjendjes (faktit se fëmija ka ndonjë aftësi të kufizuar). Ky qëndrim nga ana tjetër, ndikon drejtpërdrejt mbi komunikimin e (pa)hapur të prindit me ekipin në kopsht dhe si pasojë ekipi nuk është i informuar sa duhet për vështirësitë eventuale në funksionimin e fëmijës.



**PASQYRA 9:** Përgjigju pyetjes “Sa prindër kanë konfirmuar haptas se fëmija e tyre ka aftësi të kufizuar?”

## PËRFSHIRJA NË KOPSHTE

Sipas të dhënave të marra nga hulumtimi anketues, kopshtet nuk i plotësojnë kushtet e nevojshme për të siguruar qasje fizike. Kësaj pyetjeje i kanë dhënë përgjigje 51 kopshte. Adaptimi më i shpeshtë i cili është siguruar në 66.7% të kopshteve është platforma e qasshme në hyrjen e kopshteve. Për të, në 15.7% të kopshteve janë siguruar edhe klasa dhe objekte të përshtatshme në kopshte. Pasqyra në vijim i ilustron përgjigjet për këtë pyetje.



#### **PASQYRA 10: Përgjigje të pyetjes “çfarë përshtatjesh janë bërë që të sigurohet qasje fizike në kopshtin Tuaj?”**


Gjatë vizitave në terren vumë re se, kur bëhet fjalë për qasjen, e qasshme është hyrja në kopsht, por jo edhe pjesa e brendshme. Gjendja me qasjen në kopshte është identike me qasjen në shkolla. Shumica e kopshteve janë ndërtuar me një nivel, edhe pse ekzistojnë kopshte me dy, madje edhe më tepër nivele, ku nuk ka ashensor kurse nivelet lidhen me shkallë ndërmjet tyre. Platformat në hyrjen e kopshteve nuk janë ndërtuar gjithmonë sipas standardeve: **“Platforma e cila është në kopsht është e pjerrët, vështirë se kalohet me karrocë.”**

Vështirësia më e madhe në lidhje me qasjen është madhësia e klasave. Shumica e objekteve, gjatë vizitave në terren edhe gjatë kohës së fokus grupeve, morëm informacion she madhësia e klasave nuk përputhet me numrin e grupeve. Për shembull, në një klasë që është projektuar për 20 fëmijë, ka mbi 30 fëmijë. Numri i madh nga njëra anë dhe kushtet e pa siguruar nga ana tjetër e bëjnë të pamundur punën individuale dhe procesin e adaptimit për çdo fëmijë, si edhe për fëmijën me aftësi të kufizuara: **“Kushtet janë faktor i rëndësishëm. Adaptimi i këtyre fëmijëve, duhet të vazhdojë më gjatë. Gjithnjë edhe më pak kemi mjedis stimulues për çdo fëmijë.”**

Gjatë vizitave në terren në një nga kopshtet morëm të dhënë se një fëmijë me aftësi trupore të kufizuar është përfshirë në objekt pa qasje. Prindërit kanë pasur mundësi ta regjistrojnë edhe në objekt tjetër të të njëjtit kopsht i cili ka qasje, por kanë insistuar që të jetë në atë objekt për shkak të fëmijëve në grup dhe të edukatores. Më vështirë është qasja në kuzhinën, ku ushqehen fëmijët, sepse është në katin e poshtëm, ku shkohet nëpërmjet shkallëve, kurse fëmija ka probleme me lëvizjen.

Koncepti i tualetit të qasshëm në kopshte nuk është aspak i njohur. Në pyetësonin anketues një kopsht është përgjigjur se ka tualet të qasshëm. Gjatë vizitave në terren nuk vumë re tualete të qasshme në kopshtet e vizituar, kurse kjo e dhënë është pohuar edhe nga deklaratat e marra nga fokus grupet.

Gjendja është edhe më e papërshtatshme kur bëhet fjalë se a ka mjete dhe pajisje (të përshtatura) pedagogjike-didaktike (të qasshme). Shumica e kopshteve 58.5% janë përgjigjur se nuk kanë pajisje të tilla e cila e lehtëson përfshirjen aktive të fëmijëve me aftësi të kufizuara:



**PASQYRA 11:** Përgjigjet e pyetjes “A ka në kopshtin Tuaj mjete dhe pajisje vizuale të qasshme (të përshtatura) pedagogjike-didaktike?”


43,4% e kopshteve kanë deklaruar se kanë në dispozicion materiale të përshtatura didaktike. Në këtë grup hyjnë kopshtet ku defektologët dhe/ose logopedët përpilojnë materiale për punë individuale me këta fëmijë, ose kopshtet që kanë marrë pjesë në trajnime dhe në projekte ku kanë marrë donacione të caktuara.

Gjatë zbatimit të fokus grupeve një pjesëmarrës theksoi: **“Morëm donacione të cilat i investuam në ndërtimin e dhomës senzore. Nga përdorimi i deritanishëm rezultatet janë pozitive.”** Për fat të keq, shembujt e tillë pozitivë janë të rrallë.

**“Çojmë lodra nga shtëpia, nuk kemi marrë asgjë të re nga viti 2007. Gjendemi disi vetë, falë mundësisë që na e ofron interneti”;** thotë një përfaqësues nga një kopsht tjetër.


Në pyetësin anketues, nga materialet plotësuese didaktike kopshtet thonë se kanë në dispozicion libra me ilustrime, kartela për komunikim, materiale për integrim sensor. Një pjesë e kopshteve kanë lap-top, projektor, tablet.

Në aspektin e zbatimit të teknologjisë informatike gjendja është si vijon:



**PASQYRA 12:** Përgjigjet e pyetjes “A përdorni në kopshtin Tuaj gjatë punës me fëmijët teknologji informatike?”

Sipas përgjigjeve të dorëzuara, 77.2% e kopshteve nuk kanë defektolog në suazat e ekipit profesional. Në ato kopshte ku ekipi ka edhe defektolog ai punon me kohë të plotë pune. Në një nga kopshtet, që e vizituar gjatë vizitave në terren, janë angazhuar dy defektologë. Gjatë kësaj, defektologët janë të obliguar për të gjitha objektet e kopshtit. Aty ku ka dy defektologë, bëhet ndarje e punëve sipas objekteve. Pasqyra e mëposhtme e ilustron gjendjen e marrë nga hulumtimi anketues:



### **PASQYRA 13: Përgjigjet e pyetjes "A ka në ekipin profesional të kopshtit Tuaj defektolog"**

Sipas bisedave gjatë vizitave në terren, defektologët konsiderojnë se roli i tyre duhet të jetë mbështetje, rol këshillëdhënës me edukatorin, vlerësim i nevojave fëmijëve në bashkëpunim me edukatorin, dhe ndërtim i klimës inkluzive në bashkëpunim me edukatorët, prindërit dhe fëmijët. Vështirësia me të cilën ballafaqohen defektologët është pamundësia për të punuar individualisht me të gjithë fëmijët, madhe edhe me fëmijët me të cilët punojnë, frekuenca dhe intervali kohor i punës nuk mjafton dhe nuk i plotëson nevojat. **"Sa i lumtur ishte fëmija im në kopsht është një fjali që e dëgjoj nga prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët kanë qenë në kopshtin tonë. Roli im si defektolog është të ketë sa më shumë fëmijë të lumtur. T'u japim fëmijëve gjithçka që mund të të jenë të lumtur"**, thotë një defektolog, pjesëmarrës në fokus grup.

Një pjesë e defektologëve gjatë vizitave në terren deklaruan se mbështetjen nga edukatorët dhe prindërit e sigurojnë nëpërmjet trajnimeve të brendshme. Përveç defektologëve gjysma e kopshteve që i janë përgjigjur pyetësorit, si anëtar të ekipit profesional kanë logopedë (53.2%), psikologë (51.1%), pedagogë (42.6%) dhe punonjës socialë (21.3%). Ekzistojnë edhe ekipe ku ka edhe persona mjekësorë.


Përkundrejt kësaj, shqetëson fakti se në 13 (22.4%) e kopshteve, nga 58 kopshte gjithsej të cilat i kanë dhënë përgjigje pyetësorit nuk kanë ekip profesional.

Rolin e ekipeve të ekspertëve, të anketuarit e fokus grupeve dhe gjatë vizitave në terren e reflektojnë nëpërmjet mbështetjes së edukatorëve, punës individuale me fëmijët dhe punës këshillimore me prindërit. Të anketuarit theksuan që një defektolog i veçantë është pak në një kopsht dhe koha dhe frekuenca e punës me fëmijët me aftësi të kufizuara nuk është e mjaftueshme.

Ekipet e pakompletuara profesionale dhe mungesa e defektologëve në kopshte e bëjnë më të vështirë dhe më të pasigurt punën me fëmijët me aftësi të kufizuara. Gjatë vizitave në terren dhe gjatë fokus grupeve, veçanërisht nga kopshtet ku nuk ka shërbime profesionale ose kur nuk ka defektolog të punësuar, bashkëbiseduesit theksuan se suksesi më i madh në përfshirje do të arrihej nëse punësohen defektologë në kopshte. Nga bisedimet u konstatua se defektologu është mbartësi dhe faktori kryesor për përfshirje. Këto pohime tregojnë një nivel të ulët të vetëdijes për rolin dhe përgjegjësinë e edukatorëve për zbatimin e përfshirjes. Në një mënyrë, kjo mund të interpretohet si një qëndrim që fëmijët me aftësi të kufizuara janë "obligim" i defektologut. Pohimet e tilla nuk e mbështesin konceptin e përfshirjes. Ndarja e vazhdueshme e fëmijëve me aftësi të kufizuara nga grupi dhe puna individuale me defektologun në të njëjtë dhomë ose në një dhomë tjetër, nuk është në drejtim të përfshirjes së tyre në grup. Nëse në kopsht ka defektolog të punësuar, por ka një nivel të ulët të vetëdijes dhe paragjykime për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara nga ekipi arsimor-edukues, atëherë nuk mund të pritët përfshirje e suksesshme. Edukatorët, në bashkëpunim me kujdestaret, janë mbartësit kryesorë të përfshirjes në kopshte, kryesisht me qëndrimet e tyre, si dhe me aftësitë dhe njohuritë për punë. Qëndrimet ndryshohen me vështirësi, kurse njohuritë dhe aftësitë fitohen nëpërmjet formave të ndryshme të të mësuarit, vetëm nëse njeriu ka dëshirë për të mësuar.



Në përgjithësi, nevojitet përforsim i mëtejshëm i njohurive dhe shkathtësive të ekipeve profesionale për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara.



**SHËNIM:** në një pyetësor janë dhënë dy përgjigje për këtë pyetje


**PASQYRA 14:** Përgjigjet e pyetjes “Në aspektin e aftësisë së ekipit profesional për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara, Ju lutemi, shënoni pohimin që e reflekton gjendjen në kopshtin tuaj”

Edukatoret kanë nevojë të theksuar për trajnim shtesë për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara. Madje, 74.1% e kopshteve kanë theksuar se edukatorët e tyre kanë nevojë për përparim të njohurive për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara. Nevoja për trajnim të kuadrit profesional dhe edukator – kuadri kujdestar doli edhe nga vizitat në terren edhe në fokus grupet. Të pranishmit përmendën trajnime me UNICF-in, Megjashin, Unionin e Defektologëve, Metodologjinë Montesori. Këto trajnime janë në bazë të projekteve që janë zbatuar në shtetin tonë dhe nuk kanë mundësi të gjitha kopshtet të marrin pjesë në to.

Përveç kësaj, qasja e tillë nuk mundëson qëndrueshmëri dhe nuk i zgjidh vështirësitë me të cilat ballafaqohet sistemi. Në fokus grupet, përfaqësuesit e një kopshti i cili ka ekip profesional të kompletuar me dy defektologë, logopet, punonjës social dhe psikolog, theksuan se kanë marrë pjesë në trajnime të cilat janë më specifike dhe për të cilat kopshti ka veçuar të holla për përforsim të kompetencave profesionale për të punësuarit e vet. Sipas tyre, përveç, edukatorëve, është shumë e rëndësishme të ketë trajnime edhe për kujdestaret, të cilat janë kuadri thelbësor, por janë të përjashtuara nga iniciativat e tilla. **“Problem janë edhe qëndrimet e të gjithëve ne në mjedisin ku funksionojmë. Mungesa e punëtorëve për ndryshim të këtij drejtimi dhe sensibilizim më i madh i të gjitha palëve të përfshira! – thonë përfaqësuesit e fokus grupeve. Ata insistojnë të ketë trajnime edhe për prindërit. Deri tani vetëm një kopsht ka bërë këshillimore për prindërit, kurse një pjesë e defektologëve në kopshte bëjnë trajnime për prindërit, por në to nuk ka shumë pjesëmarrje: “Shpallëm trajnim për prindërit me temë aftësitë e kufizuara, por erdhi vetëm një prind”. Sipas të dhënave të marra konsiderojmë se nuk nevojitet trajnim për njohuritë e prindërve saç nevojitet të punohet mbi qëndrimet e tyre, si dhe mbi normat sociale. Trajnimi duhet të jetë në nivel më të lartë.**

Deri më tani vetëm një kopsht, nga të gjitha kopshtet e vizituara dhe morën pjesë në fokus grupet kanë veçuar mjete personale për trajnim të të punësuarve të vet në lidhje me temat për aftësitë e kufizuara. Në këto trajnime është mundësuar edhe trajnim për kujdestaret. **“Kujdestare nuk i përmend askush, kurse pjesën më të madhe ato e kalojnë me fëmijët. Ato duhet të përfshihen, ta njohin aftësinë e kufizuar dhe të reagojnë dhe veprojnë si duhet me fëmijët.”**

Përveç nevojës për trajnim, edukatorët theksojnë se nevojiten edhe stimulime të tjera që të jenë më të motivuar për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara: **“A punoni me 20 apo me 40 fëmijë nuk është njësoj. A keni apo nuk keni fëmijë me aftësi të kufizuara në grup, nuk ndryshon shumë, të gjithë jemi njëjtë.”**



**PASQYRA 15: Përgjigjet e pyetjes “Në aspektin e aftësisimit të edukatoreve për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara, Ju lutemi shënoni pohimin që e pasqyron më mirë gjendjen në kopshtin Tuaj”**

Në raport me monitorimin dhe evidentimin e progresit të fëmijëve, nga analiza e përgjigjeve të pyetësori anketues, rezulton se nuk ka procedura të unifikuara për vlerësimin, monitorimin dhe evidentim të punës me fëmijët me aftësi të kufizuara. Më shpesh në kopshte ku ka grupe profesionale, defektologët dhe logopedë, ata kryejnë monitorim të brendshëm dhe regjistrim të aktiviteteve, por kjo i lihet kreativitetit të tyre. Nuk ka mënyra dhe procedura të unifikuara, sipas deklaratave të marra nga vizitat në terren dhe nga grupet e fokusit.


Sipas të dhënave të marra nga sondazhi i anketës, deri më tani asnjë prej kopshteve nuk ka marrë mbështetje nga autoritetet lokale për përmirësimin e punës me fëmijët me aftësi të kufizuara. Nga vizitat në terren, disa kopshte thanë se kanë marrë mbështetje nga bashkësia e biznesit, por nuk ishin të orientuara për nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Nga aktorët e tjerë, kopshtet kanë bashkëpunuar me organizatat qytetare dhe qendrat ditore.

Drejtori i një kopshti i fokus grupit tha se kopshti kishte marrë fonde nga bashkësia e biznesit për të pajisur një dhomë senzore.

Ndonëse kopshti i ka mjetet, megjithatë ka vështirësi në lidhje me dokumentacionin e tenderit dhe pagesën e taksave kur blejnë lodrat dhe pajisjet e nevojshme për dhomën. Këto barrierat administrative e zgjasin të gjithë procesin e prokurimit dhe janë një vështirësi shtesë për kopshtin.

## PËRVOJA DHE PRAKTIKA

Në aspektin e përgatitjes dhe zbatimit të planeve individuale, gjendja është si vijon:



### **PASQYRA 16: Përgjigjet e pyetjes “A përpilohen dhe zbatohen, në kopshtin Tuaj, për fëmijët me aftësi të kufizuara plane individuale?”**

Sipas përgjigjeve të hulumtimit anketues, në 26 kopshte nuk përpilohen plane individuale arsimore (PIA) për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Kjo pyetje ishte pjesë edhe në fokus grupet. Në pjesëmarrës në fokus grupet për edukatore thotë: **“Përpilohet vetëm që të kemi se çfarë të tregojmë nëse vjen inspektim. Edukatorët tregojnë rezistencë dhe nuk duan të bëjnë plane, për to kjo është një punë administrative shtesë.”**

Prindërit, pjesëmarrës në fokus grupe, theksuan se në kopshtet ku venë fëmijët e tyre nuk bëhet plan individual. Ata konsiderojnë se është shumë e rëndësishme të punohet sipas planit individual i cili do të përpilohet në bashkëpunim me shërbimin profesional: **“Në kopshtin tonë nuk ka kuadër profesional, nuk ka kush të japë drejtime për punën me këta fëmijë.”**

Një kopsht gjatë vizitës në terren deklaroi se përpilon plan individual për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara. Përpiqen ta përfshijnë edhe prindin, por deri në atë masë që edhe ai është i interesuar. Ky plan është pjesë dosjes së fëmijës. Në këtë kontekst, me rëndësi të madhe është ekzistimi dhe mbajtja e komunikimit me shkollat gjatë regjistrimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Më shpesh, sipas pjesëmarrësve në fokus grupet, nuk ekziston vazhdimësi dhe bashkëpunim në këtë pjesë. Gjithçka i është lënë vullnetit të prindit dhe arsimtarit dhe zakonisht përdoren kontakte personale, kurse nuk është një aktivitet obligativ. Sipas pjesëmarrësve në fokus grupet ekziston interpretim i ndryshëm i dispozitës **“dosja zhvillimore e ndjek fëmijën”**. Nga kjo del nevoja që të precizohet a do ta dërgojë prindi dosjen në shkollë apo kjo do të kërkohet me obligim zyrtar për të gjithë fëmijët gjatë regjistrimit në shkollë.

Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në aktivitete dhe përmbajtje shtesë dhe të lira është e kufizuar. Të dhënat e marra nga pyetëtori anketues, dëshmojnë se fëmijët me aftësi të kufizuar marrin pjesë vetëm në disa aktivitete të lira. Pjesëmarrja varet nga lloji dhe shkalla e kufizimit.

Kopshti i përpilon dhe përshtat aktivitetet e lira dhe shtesë që të mundësojë pjesëmarrje të barabartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në përputhje me interesat e tyre personale	23	42,6%
Fëmijët me aftësi të kufizuara marrin pjesë në një pjesë të aktiviteteve shtesë dhe të kufizuara, ku mund të përshtaten duke marrë parasysh aftësinë e tyre të kufizuara	23	42,6%
Fëmijët me aftësi të kufizuara nuk marrin pjesë në aktivitetet shtesë dhe të lira	0	0%
Nuk ka fëmijë me aftësi të kufizuara në kopshtin tonë	14	25,9%

**PASQYRA 17:** Përgjigjet e pyetjes “Në aspektin e pjesëmarrjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në aktivitetet shtesë dhe të lira (shfaqje, vizita, festa etj.) Ju lutemi, shënojeni pohimin që e pasqyron më mirë gjendjen në kopshtin Tuaj”

Të dhëna të ngjashme janë marrë gjatë vizitave në terren, si dhe nga fokus grupet. Kopshtet e fëmijëve thonë se ato i përfshijnë dhe përpiqen t’i përfshijnë fëmijët me aftësi të kufizuara në të gjitha aktivitetet me fëmijët e tjerë. Sipas tyre, prindi është ai që vendos nëse fëmija do të përfshihet apo jo.

Përvojat dhe përshtypjet e prindërve janë të ndryshme. Disa prindër kanë përvojë negative nga përfshirja e fëmijës me aftësi të kufizuara në aktivitetet të cilat organizohen nga kopshti, kurse prindërit e tjerë janë të kënaqur.

**“Kur u organizua vizita në teatër, edukatorja më tha se fëmija im nuk mund të shkojë, sepse në teatër duhet të rrinë urtë, kurse fëmija im bërtet. U propozova të shkoj me të, nëse shqetësohet ta nxjerr jashtë, nuk pranuan.” “Në një shfaqje ku fëmija im me shokët ishin në publikë, kishim përvojë shumë të keqe. Fëmija im kërcente nga gëzimi. Edukatorët e nxorën në dhomën tjetër, që ta ndjekë shfaqjen nëpërmjet xhamit.”**

**“E merrnin kudo me vete. Fëmijët e tjerë e ndihmonin. E kapnin për dore gjithmonë dy shokë. Në këtë mënyrë merrte pjesë në shfaqje, dhe merrte shumë duartrokitje nga prindërit e shokëve të tij. Ne qanim nga gëzimi.”**

Kur bëhet fjalë për reagimin më të shpeshtë nga prindërit e fëmijëve pa aftësi të kufizuara në lidhje me përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në grupe, sipas përgjigjeve të kopshteve dhe si e perceptojnë ato këtë pyetje, pjesa më e madhe e pranojnë praninë e tyre. Vijon një pasqyrë tabelore me përgjigjet e dhëna nga kopshtet, në lidhje me reagimin e prindërve pa aftësi të kufizuar, që dëshmon se prindërit i pranojnë fëmijët me aftësi të kufizuar dhe nuk manifestojnë qëndrim negativ ndaj përfshirjes së tyre në kopshte.

e mbështesin përfshirjen e tyre si anëtarë të barabartë dhe i nxitin fëmijët e tyre të shoqërohen, bashkëpunojnë dhe t'i mbështesin fëmijët me aftësi të kufizuara	15	27,3%
e pranojnë praninë e tyre	22	40%
nuk kanë ose nuk shfaqin qëndrim rreth përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara	17	30,9%
nuk e pranojnë përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke konsideruar se kjo e ul cilësinë dhe dinamikën e aktiviteteve, por nuk ndër marrin iniciativa në lidhje me këtë	1	1,8%
marrin aktivisht iniciativa në kopsht dhe në instancat e tjera për të çregjistruar fëmijët me aftësi të kufizuar nga grupet e fëmijëve të tyre	0	0%
nuk ka fëmijë me aftësi të kufizuar në kopshtin tonë	13	23,6%
tjetër (Ju lutem shpjegoni):	2	3,6%

**PASQYRA 18: Përgjigjet e pyetjes “Si është reagimi i prindërve me fëmijë pa aftësi të kufizuara në lidhje me përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në grupe?”**

Kopshtet në pyetësorin anketues kanë dhënë dy përgjigje përshkruese, se më shpesh ka reagime nëse fëmijët janë agresivë dhe e prishin qetësinë e grupit.

Kjo temë u diskutua edhe gjatë vizitave në terren dhe me fokus grupet, ku të pranishmit deklaruan se ka pasur reagime gojore, por deri më tani nuk ka pasur reagime të mëdha dhe kërcënime nga prindërit

e fëmijëve pa aftësi të kufizuara. Kur bëhet fjalë për moshatarët, kopshtet e fëmijëve nuk hasin ndonjë vështirësi. Fëmijët pranohen dhe edukatorët përpiqen të inkurajojnë pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara sa më shumë që të jetë e mundur.

Në lidhje me opsionet e zgjedhura që e pasqyrojnë më së afërmi qëndrimin e kopshteve për edukimin parashkollor gjithëpërfshirës, kopshtet e fëmijëve, në përqindjen më të madhe (49%), besojnë se arsimi parashkollor gjithëpërfshirës është për interesin më të mirë të të gjithë fëmijëve.

Arsimi parashkollor gjithëpërfshirës është i domosdoshëm dhe është për interesin më të mirë të të gjithë fëmijëve	25	49%
Arsimi parashkollor gjithëpërfshirës është mundësi e mirë vetëm për një pjesë të fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët mund të marrin pjesë në aktivitete	21	41%
Arsimi parashkollor gjithëpërfshirës, në formën si zbatohet te ne, nuk është mundësi përkatëse për fëmijët me aftësi të kufizuara	8	15,7%
	0	0%

**PASQYRA 19:** Përgjigjet e pyetjes “Cila nga opsionet e dhëna e shpreh më afër qëndrimin e kopshtit Tuaj në lidhje me arsimin parashkollor gjithëpërfshirës?”

Kopshtet kishin mundësi të ndajnë mendimet e veta se cilat janë nevojat e tyre primare për të përmirësuar procesin përfshirës dhe për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara. Nga pyetësi anketues i morëm të dhënat dhe përgjigjet në vijim:



NEVOJA PRIORITARE	SHKALLA E RËNDËSISË
Punësim të defektologut	219
Trajnime për edukatorët për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara	231
Trajnim për ekipin profesional për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe sigurim i mbështetjes së edukatoreve për punë me ta	226
Përmirësimi i qasjes fizike në objektet	233
Sigurimi i mjeteve pedagogjike-didaktike, pajisjeve vizuale dhe teknologjisë	226
Sigurim i shumës më të lartë të mjeteve financiare për kopshtet që të plotësojnë nevojat individuale të fëmijëve me aftësi të kufizuara	261
Ndryshime në kornizën juridike	209
Tjetër	23

**PASQYRA 20:** Përgjigjet e pyetjes “Përcaktoni dhe vlerësoni sipas rëndësisë nevojat prioritare për përparim të punës me fëmijët me aftësi të kufizuara në kopshtin Tuaj”

Për këtë pyetje, kopshtet duhet të tregojnë sipas shkallës së rëndësisë, në një shkallë prej 1 deri në 7, cilat janë nevojat e tyre prioritare. Nga tabela, e cila përmbledh notat dhe shkallët e rëndësisë të marra nga pyetësi anketues, shihet se kopshtet kryesisht kanë më shumë nevojë të sigurojnë një sasi më të madhe të mjeteve të dedikuara për plotësimin e nevojave individuale të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe për përmirësimin e qasjes fizike në objekte.

Nga përgjigjet shtesë për këtë pyetje kopshtet theksojnë se u nevojiten:

- ▶ angazhim të asistentëve personalë;
- ▶ respektim të normës për numrin e fëmijëve në grup;
- ▶ përgatitje më e madhe e kuadrit edukues-kujdestar për punë me fëmijë;
- ▶ kompletimi i ekipeve profesionale,
- ▶ përmirësimi i raportit midis numrit të personave profesionalë të angazhuar dhe fëmijëve me aftësi të në grupe.

## KOMENTE SHITESË

Në pyetësin anketues, gjatë vizitave në terren si dhe gjatë fokus grupeve, të anketuarit patën mundësinë të japin komentet shtesë. Të gjitha komentet u sublimuan dhe lidhen me:

- ▶ përmirësim i kushteve fizike për punë dhe sigurim të qasjes në objekte (rinovim apo ndërtim i objekteve të reja);
- ▶ sigurim i mjeteve didaktike dhe i pajisjeve të reja për punë;
- ▶ sigurim i ekipeve profesionale complete;
- ▶ respektim i numrit normativ mbi numrin e fëmijëve dhe zvogëlim të numrit të fëmijëve në grup;
- ▶ edukim i kuadrit edukues-kujdestar;
- ▶ trajnim dhe specializim për fusha të caktuara të bashkëpunëtorëve profesionalë;
- ▶ ndryshim në programin për studime universitare për studentët e fakulteteve pedagogjisë (përfshirje e lëndëve të cilat kanë metodika për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara);
- ▶ rregullim i formës së qëndrimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara;

- ▶ edukim i prindërve për tema lidhur me aftësitë e kufizuara;
- ▶ përforcimi i bashkëpunimit ndërsektorial (shkolla, qendra ditore, organizata qytetare, ministri);
- ▶ krijim i masave stimuluese për motivim të edukatoreve për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara;
- ▶ rregullimi i normativës ligjore me dispozitë ku prindi duhet të obligohet të dorëzojë dokumentacion për aftësinë e kufizuar të fëmijës së vet;
- ▶ sigurim i asistentëve personalë.

## RRËFIME NGA TERRENI

Në këtë pjesë të hulumtimit do të tregohen rrëfimet që vijnë nga vizitat në terren. Disa nga ngjarjet janë botuar në mënyrë anonime dhe disa janë botuar me të dhëna me qëllim që të stimulohet shkëmbimi i përvojave dhe të pasqyrohen modelet pozitive që ekzistojnë në disa kopshte. Ata nuk lidhen me zgjidhjet e sistemit, por janë fryt i krijimtarisë dhe iniciativave të kolektivave të kopshteve.

Ekipi hulumtues gjatë përzgjedhjes së kopshteve për vizita në terren, vendosi të vizitohet një kopsht fëmijësh të vendosur në një mjedis rural, i cili përfshin një numër relativisht të vogël fëmijësh, ndër të cilët fëmijët me paaftësi nuk janë regjistruar në pyetëtorin e pyetësorit. Ideja e vizitës në këtë kopsht erdhi gjatë shqyrtimit të pyetësorëve. Këto kritere janë marrë parasysh gjatë vizitës së çdo kopshti, por kërkesa që të gjithë të jenë të pranishëm nuk ishte e obligueshme. Kopshti i fëmijëve ndodhet në një kodër afër një Qendre për kujdes ditor për personat me aftësi të kufizuara, i cili edhe pse ekziston prej disa vitesh ende nuk kanë filluar me punë. Në hyrje, e cila është e vështirë të arrihet për shkak të rrugës së pjerrët, por edhe për shkak të bërllokut të mbledhur ndërtimor, ekipi është pritur ngrohtësisht nga fytyra të buzëqeshura, të etura për biseda dhe punë. Brendësia e kopshtit nuk e pasqyron përshtypjen fillestare. Klasa të gjera, të rregulluar me inventar të ri, atmosferë e qetë pune. Ekipi përbëhet nga edukatorë, kujdestarë, arkëtar, drejtor dhe amvise. Sipas deklaratave të bashkëbiseduesve, kopshti nuk i takon një ekip ekspertësh, pasi mbulon një numër të

vogël fëmijësh. Është i vetmi në rajon që mbulon rreth 30,000 banorë. Prindërit nuk janë të motivuar për t'i sjellë fëmijët e tyre në një kopsht për shkak të terrenit të paarrtshëm dhe largësisë nga vendbanimi. Edhe pse kopshti, ka paraqitur një kërkesë për transport të organizuar, nuk është miratuar deri më tani. Terreni i vështirë si një faktor tjetër jo vetëm që i kufizon prindërit, por gjithashtu i kufizon edhe punonjësit gjatë ditëve të dimrit. Nëse bien borë, ata nuk mund të vijnë në vendin e punës. Për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe përfshirjen e tyre në kopsht, as nuk diskutohen në këtë mjedis, për shkak të mendimit dhe pritjeve që ata do të jenë përdorues të Qendrës ditore. Në pritje të funksionimit të qendrës, brezat fëmijësh kalojnë pa ndërhyrje dhe stimulim të hershëm. Natyra e bukur, ideale për aktivitete në kohën e lirë dhe për shëtitje, është një burim i papërdorur: **“Kemi frikë t'i nxjerrim fëmijët edhe në ballkonet të cilat i kemi nga çdo klasë, për shkak të gjarpërinjve përreth objektit.”** Dëshira për punë nuk i ka lëshuar, edhe pse deri më tani nuk i ka vizituar askush, nuk i ka ftuar në trajnim, as nuk u ka dhënë ndihmë në punën e deritanishme.

Terreni i vështirë për të arritur te objektet është një nga vështirësitë me të cilën ballafaqohen shumica e kopshteve. Ekipi hulumtues vizitoi një kopsht fëmijësh të vendosur në pjesën periferike të qytetit. Hyrja kryesore ishte e paarrtshme, por në anën e pasme ka një platformë që nuk është ndërtuar sipas standardeve dhe çon deri te hyrja e cila lidhet me kuzhinën. Supozojmë se ajo është bërë që ta shfrytëzojnë furnizuesit me ushqim. Mungesa e parmakëve mbështetës në platformë është në drejtim të vërtetimit të supozimit. Kopshti nuk ka paraqitur fëmijë me aftësi të kufizuara, kurse në momentin e intervistës, në oborr vjen një prind me fëmijët e tij. Dy fëmijë mbanin syze me dioptri të theksuar. Fëmijët gjenden vetë në hapësirën duke u mbështetur. Kopshti nuk i ka evidentuar si fëmijë me aftësi të kufizuara, sepse nuk ka informacion se dëmtimi i shikimit është një prej kategorive të aftësive të kufizuara. Gjendja është e vështirë sepse kopshti nuk ka ekip profesional. Edhe pse është dërguar kërkesë, mungon zëvendësimi i një edukatoreje e cila prej tre muajsh është me leje lindjeje.

Përveç numrit të pamjaftueshëm të të punësuarve, kopshteve u mungojnë shërbimet e ndërhyrjes së hershme në nivel lokal. Kopshti është pranë qytetit ku ka Ent për dëgjim, të folur dhe tingull, deri para tre vjetësh ka pasur mbështetje nga logopedë nga ky ent. Në pyetësonin anketues, kopshti nuk kishte paraqitur fëmijë me aftësi të kufizuara, për shkak të mungesës së shërbimit profesional dhe

mungesës së dokumentacionit adekuat për fëmijët. Në vizitën në terren, ata theksuan se numri i fëmijëve me vështirësi në të folur nuk është aspak i shqetësues. Por nuk duhet të jetë i papërfillshëm dhe fakti që ata nuk marrin ndonjë mbështetje dhe se prindërit nuk kanë gjithmonë mjetet për të shkuar në trajtim në komunën fqinje ku ofrohet ky shërbim. Kopshti ndonjëherë, pasi sheh gjendjen e familjes, nuk është në gjendje as ta rekomandojë këtë shërbim si një mundësi trajtimi në kohë.

Midis praktikave të mira të cilat janë vërejtur në terren, është edhe puna në kopshtin “Dime Mirçev” në Veles, ku punonjësit kanë arritur të gjejnë një zgjidhje në drejtim të sigurimit të shërbimeve nga defektologu. Përkatësisht, kopshti, i vendosur në gjashtë objekte, me një ekip të plotë ekspertësh që përfshin dy defektologë, ofron shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara që nuk janë në nivel lokal. Familjet që nuk përfshijnë fëmijë në kopsht, u është mundësuar të përdorin trajtim nga defektologu, punë individuale me defektolog, të siguruar nga kopshte. Për fëmijët me aftësi të kufizuara, kopshti ka siguruar një hapësirë për integrimin sensor, ku trajtimi ofrohet nga dy edukatorë të trajnuar për këtë metodë pune. Trajnimi u siguroi nga fondet e kopshtit, kurse në përgatitjen dhe pajisjen e dhomës senzore në kopsht, mjetet u siguruan nga donatorët.

Përveç shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, nevojiten shërbime që përfshijnë prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Kopshti “Fidani” në Shkup zhvillon aktivitete në gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke dhe është një shembull i përfshirjes nga aspekte të ndryshme. Slogani i ekipit profesional të kopshtit është “nuk ka fëmijë që nuk përshtatet, ka prindër që heqin dorë”. Në kontekstin e këtij slogani, në kopsht ekziston një Qendër këshillimi për prindërit që ofron shërbime mbështetëse për prindërit.



VĚREJTJET  
PĚRFUNDIMTARE

Konstatimi i përgjithshëm që rrjedh nga hulumtimi i kryer është se arsimi parashkollor nuk ofron kushtet dhe mundësitë e nevojshme për pranim dhe zhvillim optimal të çdo fëmije. Në mungesë të një mekanizmi për identifikimin sistematik, evidentim dhe monitorim të fëmijëve me aftësi të kufizuara që nga moshën më të hershme, mundësitë për stimulim të hershëm janë reduktuar ndjeshëm, gjë që e bën të vështirë qëndrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte, të cilat zakonisht reduktohen në kujdestari, por jo edhe në komponentin arsimor dhe zhvillimin e hershëm stimulues. Gjithashtu, legjislati nuk është plotësisht në përputhje me dispozitat e dokumenteve kryesore ndërkombëtare në këtë fushë: KDPAK, KDF dhe Deklarata e Salamankës, edhe pse shteti e ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ka mangësi në hapat dhe aktivitetet e ndërmarra për zbatimin e tërësishëm të saj. Nuk ka tregues të qartë që do të monitorojnë zbatimin dhe efektet e zbatimit të dispozitave të këtyre dokumenteve.

Domethënë, të dhënat e marra tregojnë mosrespektim ose vetëm respektim të pjesshëm të standardeve të përcaktuara mbi numrin e grupeve, kushtet e përshtatshme hapësinore dhe pajisjet e kopshteve. Një pjesë e kopshteve janë ndërtuar në vende krejtësisht të paarrtshme, kurse në zonat rurale ekziston mungesë e kopshteve, që përbën një fakt shqetësues, veçanërisht sepse në zonat rurale përqindja e fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor është mjaft më e ulët.<sup>14</sup> Përveç kësaj, në një nivel shumë të ulët është edhe vetëdija mbi rëndësinë e zhvillimit të hershëm fëmijëror dhe stimulimit të domosdoshëm të “moshës së artë” të zhvillimit të fëmijës, por edhe arsimi parashkollor nuk është ngritur në nivel të arsimit, prandaj kjo fazë është në nivel të kujdesit dhe edukimit.

Nuk ka ambient të favorshëm dhe stimulues për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte, dhe ende janë të pranishme qëndrimet stereotipike dhe paragjykimet në lidhje me përfshirjen e tyre midis fëmijëve të tjerë, të cilat për fat të keq lidhen me konstatimet e marra nga hulumtimi mbi përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat fillore dhe të mesme. Për më tepër, një nga arsytet për këtë situatë është gjithashtu e natyrës sistemore. Mungesa e ndërhyrjes së hershme si një komponent i rëndësishëm nga zinxhiri i shërbimeve që nevojiten për fëmijët me aftësi të kufizuara, ndikojnë në vlerësimin

<sup>14</sup> Sipas Hulumtimit multiindikator klaster MIKS, të vitit 2011, përqindja e fëmijëve të regjistruar në moshë nga 3-6 vjet në institucionin parashkollor në qendrat urbanet ka qenë 37, kurse në ato rurale vetëm 6.

e mëvonshëm dhe në identifikimin e aftësisë së kufizuar, me të cilën lidhet edhe zbatimi jokonzistent i obligimit ligjor për të dorëzuar vlerësim gjatë regjistrimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopsht. Të dhënat e mbledhura në terren tregojnë se ofruesit e kujdesit shëndetësor parësor, të cilët plotësojnë aplikacionet e regjistrimit me shënimin e tyre, paraqesin dokumentacion i cili nuk e pasqyron gjendjen reale të fëmijëve. Kjo e parashtron pyetjen mbi shkaqet e dorëzimit të dokumentacionit të pasaktë. Për shembull, a bëhet fjalë për mungesë të njohurive të ofruesit të kujdesit shëndetësor parësor, a është pyetje e praktikave të papërshtatshme në punën e tyre, apo ekzistojnë shkaqe të tjera?

Regjistrimi i të gjithë fëmijëve në kopsht është gjatë gjithë vitit. Në lidhje me pranimin, konstatohet se ekzistojnë listat e gjata të pritjes të cilat, si një zgjidhje e përkohshme, e vonojnë pranimin në kopshte, ku lëshohet një pjesë e periudhës për zhvillimin optimal të fëmijës. Ekziston një çekuilibër midis kapacitetit për pranimin e fëmijëve dhe nevojat reale të fëmijëve dhe familjeve për regjistrim në kopshtin e fëmijëve, kurse mungon mbështetja nga vetëqeverisja lokale në këtë fushë, si dhe mbështetja për përfshirjen nga një moshë të re. Me këtë ndërlidhet edhe vështirësia e shpërndarjes së mjeteve financiare për krijimin dhe rregullimin e kopshteve sipas masës së fëmijës.

Nga aspekti i kuadrit, u vu në dukje mungesa e kuadrit, mungesa e shërbimit profesional apo shërbim jo të plotë profesional, dhe nevojën për të zgjeruar njohuritë dhe aftësitë e kuadrit në raport me kuptimin e konceptit të aftësisë së kufizuar dhe punës me fëmijët me aftësi të kufizuara. Analiza e të dhënave të mbledhura dhe mbikëqyrjet në terren del se edukatorët kanë vështirësi në punën me fëmijët me aftësi të kufizuara, në disa aspekte kryesore, si gjatë vlerësimit, evidencës dhe monitorimit të progresit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, ashtu edhe në përgatitjen e një plani individual për punë. Nuk ekziston qasje e unifikuar për këtë çështje.



Ekipet profesionale në kopsht, në përgjithësi janë të pakompletuar, përkatësisht ekziston mungesë e shërbimeve profesionale në një pjesë të kopshteve. Aty ku ka ato nuk mjaftojnë që të sigurojnë mbështetje të vazhdueshme për edukatorët, që t'i plotësojnë normativat për punën me fëmijët me aftësi të kufizuar dhe t'i ndihmojnë gjatë nevojave të tyre reale. Përveç mospërgatitjes, është konstatuar edhe prani e paragjykimeve, si edhe kërkesë për mënyrat për anashkalim të përgjegjësisë. Edukatorët nuk e pranojnë rolin e mbartësve kryesorë të përfshirjes dhe konsiderojnë se fëmijët me aftësi të kufizuar janë përgjegjësi e defektologut. Përveç kësaj mungojnë pajisje didaktike dhe mjete të tjera vizuale, teknologjia dhe resurset për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara, hapësira të vogla për një numër të madh fëmijësh, qasje e vështirë të hyrjet, klasa dhe tualete të përshtatura për fëmijët me aftësi të kufizuar.

Në përgjithësi, është vënë re pjesëmarrje e dobët e prindërve në proceset të cilat kërkojnë pjesëmarrje të tyre aktive si partnerë: vlerësim të aftësive, mundësive dhe nevojave; krijim të planit individual dhe përshtatje të mjedisit dhe resurseve. Gjithashtu, është i ulët edhe niveli mbi nevojat e arsimit parashkollor për fëmijët midis prindërve në mjediset rurale. Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk janë të informuar sa duhet që ta dallojnë dhe të reagojnë në mënyrë përkatëse mbi aftësinë e kufizuar të fëmijës së vet. Edhe tek ata ka paragjykime, por edhe frikë nga refuzimi kolektiv të fëmijëve të tyre. Nuk ekzistojnë shërbime të cilat i drejtojnë dhe i mbështesin prindërit gjatë gjithë procesit. Rezultati është lëshimi i periudhës optimale për zhvillim të funksioneve dhe shkathtësive.

Është i vogël numri i shembujve pozitivë në kopshte, por ata nuk janë motivuar dhe shfrytëzuar sa duhet për përmirësim të gjendjes momentale, sepse përfshirja kuptohet, shpesh, nëpërmjet prizmit të mjeteve financiare. Është pozitive fakti që kopshtet mund të ofrojnë shërbime, që nuk ekzistojnë në nivel lokal, kurse janë shumë të rëndësishme për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe për familjet e tyre. Intervenimi i hershëm mund të zbatohet në suazat e kopshteve, nga

ekipi profesional, edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët nuk janë përfshirë ende në kopsht. Gjithashtu edhe puna këshilluese me prindërit është e rëndësishme në nivel lokal, kurse mund të zbatohet në kopshte, për shkak të mungesës së shërbimeve profesionale për mbështetje të tyre. Edhe pse ekzistojnë shembuj pozitivë, megjithatë, për fat të keq nuk janë në numër të madh, kurse praktika e tyre nuk është mjaft e motivuar dhe e shfrytëzuar në drejtim të përmirësimit të gjendjes momentale në shumicën e kopshteve.

Mungojnë mekanizma për shkëmbim të përvojave dhe bashkëpunimit në nivele të ndryshme të transferit të cilat i kryen fëmija me aftësi të kufizuara. Bashkëpunimi i kopshteve me shkollat fillore është në interes individual dhe përdoren kontakte personale në sigurimin e informacioneve të rëndësishme të cilat përfshijnë dosjen zhvillimore të fëmijës, kurse normativa ligjore në këtë pjesë nuk është tërësisht e qartë dhe lë hapësirë për interpretim të lirë.





# REKOMANDIME

Avokati i Popullit, me qëllim që të përmirësojë procesin e arsimit parashkollor për të gjithë fëmijët i jep këto rekomandime:

Gjatë regjistrimit dhe pranimit të fëmijëve të zbatohet në mënyrë të vazhdueshme, si edhe të plotësohen, dispozitat ekzistuese ligjore që rregullojnë këtë çështje dhe të sigurohet dokumentacioni i plotë nga institucioni relevant ku përshkruhet lloji i aftësisë së kufizuar dhe gjendja aktuale e fëmijës. Për të përmirësuar këtë proces është e nevojshme që organet kompetente të mbrojtjes sociale ta ndjekin dhe të angazhohen në procesin e vazhdueshëm të reformave të përcaktimit të llojit dhe shkallës së aftësisë së kufizuar, në përputhje me Klasifikimin ndërkombëtar të funksionalitetit, aftësisë së kufizuar dhe shëndetit.

Që të ndiqet situata me fëmijët me aftësi të kufizuara në kopshte, është e domosdoshme të vendoset një mekanizëm për identifikimin sistematik, evidentim dhe monitorim të fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte.

Nevojiten ndryshime dhe plotësime të normativës juridike për harmonizimin e plotë të legjislacionit kombëtar me dokumentet kryesore ndërkombëtare në këtë fushë: KDK, KDF dhe Deklarata e Salamankës. Këto ndryshime të përgatiten në një proces pjesëmarrës dhe konsultime me personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, sektorin civil, edukatorët dhe përfaqësuesit e shërbimeve profesionale të çerdheve, ekspertët dhe profesionistët dhe të ngjashme. Të shmanget lista e pritjes si një formë kalimtare për pranimin në çerdhe. Duke marrë parasysh përbindjen e ulët të fëmijëve të regjistruar në institucionet parashkollore në moshë prej 3 deri në 6 vjeç dhe veçanërisht mbulimin e dobët të këtij grupi fëmijësh në zonat rurale, midis të cilëve janë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara, rekomandojmë që të sigurohet një numër i mjaftueshëm i objekteve (institucioneve parashkolloreve), si dhe qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijëve për përfshirje, kujdes adekuat dhe edukim të fëmijëve, duke përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

Gjatë nderimit apo rikonstruktimit të objekteve ekzistuese të respektohen standardet e vendosura në lidhje me disponueshmërinë dhe qasjen të objektet, numrin në grupe dhe numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuar, sigurimin e pajisjeve përkatëse didaktike dhe të kuadrit i cili do t'u përgjigjet nevojave të fëmijëve.

Punëtori dhe prezantime më të shpeshta për aftësitë e fëmijëve me kufizime, por edhe për të drejtat e tyre, duke përfshirë kuadrin e kopshteve, prindërit, përfaqësuesit e bashkësisë lokale dhe të ministrive të resursit.

Të sigurohen programe në etapa, por të tërësishme, për edukimin e kuadrin kujdestar-edukues në kopshte me qëllim që ta kuptojë dhe pranojë rolin dhe përgjegjësinë e mbartësit të përfshirjes. Në këtë kontekst, fakultetet pedagogjike ta shqyrtojnë mundësinë e ndryshimit të planeve dhe programeve mësimore që ta përforcojnë përfshirjen e arsimit parashkollor gjithëpërfshirës. Të zgjidhet nëpërmjet sistemit nevoja për sigurim të ekipeve profesionale në nivel të të gjitha kopshteve dhe të saktësohet roli i tyre.

Gjithashtu, të vendoset koncept dhe model i qartë mbi rolin e defektologut në ekipet profesionale të kopshteve. Të përcaktohen nevojat e kopshteve dhe të saktësohen normativat për punë individuale me fëmijët me aftësi të kufizuara në raport me frekuencën dhe kohëzgjatjen e aktivitetit. Këtu të përdoren praktikat e vendosura tashmë si shembuj pozitivë.

Pjesëmarrje dhe mbështetje më e madhe nga vetëqeverisja lokale për fëmijët si qytetarët e saj më të vegjël dhe në këtë kontekst të gjenden mënyra dhe mekanizma që të zmadhohet vetëdija te vetëqeverisjet lokale, familjet, prindërit dhe tek e gjithë bashkësia lokale mbi rëndësinë e arsimit parashkollor si periudhë kryesore në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve.

Në fund, duhet të theksohet roli i prindërve – dhe i fëmijëve me aftësi të kufizuara, dhe i fëmijëve pa kufizime – në arritjen e nivelit më të lartë të përfshirjes, jo vetëm në arsimin parashkollor, por në shoqëri në tërësi. Mundësimi i mbështetjes së vazhdueshme për të gjithë fëmijët e vendos nevojën që kopshtet t'i përfshijnë edhe prindërit në të gjitha aktivitetet si partnerë të tyre. Që të arrihet e gjithë kjo rekomandohet ndërmarrja e masave në drejtim të përforcimit të vetëdijes së prindërve dhe theksimin e rëndësisë së tyre si partnerë aktivë në kopshte. Duhet të stimulohen veçanërisht prindërit nga mjediset rurale që ta kuptojnë rëndësinë e arsimit parashkollor dhe të regjistrojnë fëmijët e vet në kopshte. Të sigurohet mbështetje për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara në momentet e tejkalimit të frikës nga siguria kolektive dhe pranimi i vështirësive të fëmijës së tij. Të ndërmerren masa për plotësim të nevojave për shërbime profesionale për mbështetje

të familjeve, ku do të shqyrtohet edhe mundësia për shfrytëzim të kapaciteteve të ekipeve profesionale dhe të respektohet standardi i krijimit dhe ekzistimit të këshillimoreve në suazat e kopshteve.

Mësimi nga praktikat e mira nuk është shfrytëzuar sa duhet. Avokati i Popullit rekomandon që kopshtet të nxiten midis tyre nëpërmjet prezantimit të ndryshimeve, praktikave dhe shembujve pozitivë, që do të jetë burim idesh për zgjidhje pragmatike në punën e përditshme dhe përgjegjësi më e madhe individuale, përkushtim dhe vullnet për ndryshime. Hapat e ndërmarra nga disa ekipe pune, të cilat u theksuan si shembuj të mirë, janë dëshmi se përfshirja nuk është çështje vetëm e nevojës për mjete financiare. Nevoja për arsimim shtesë u shfaq si një gjetje në këtë hulumtim. Pa dyshim, çdo mundësi për të marrë pjesë në një trajnim ose punëtori rreth temave që lidhen me përfshirjen është e mirëpritur. Megjithatë, nuk duhet harruar se mësimi nuk është dhe nuk duhet të kushtëzohet nga forma e transferimit të njohurive. Takime joformale më të shpeshta dhe/ose vizita për shkëmbimin e përvojave midis personelit të kopshteve në raport me përfshirjen, që do të jenë të dobishme për punonjësit, si dhe organizim i ditëve efikase të hapura për prindërit e fëmijëve, dëgjimi i mendimeve, sugjerimeve dhe ideve të tyre për përmirësimin e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara. Të identifikohen dhe promovohen praktikat dhe modelet e suksesshme të përfshirjes në shkolla, si dhe të vendosen mekanizma mbrojtës për shkëmbim të informacioneve me shkollat ku do të vazhdojnë arsimin fëmijët me aftësi të kufizuara pas përfundimit të kopshtit. Mandej, në ligj duhet të saktësohet dispozita mbi dosjen zhvillimore të fëmijës që të shmanget mundësia e interpretimit të lirë. Dosja zhvillimore me obligim zyrtar ta ndjekë çdo fëmijë gjatë regjistrimit në shkollë.

SHTOJCA





# SHTOJCA 1

---

## LISTA E DOKUMENTEVE

Objekt i analizës në kuadër të hulumtimit janë dokumentet në vijim:

- ▶ Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (Ligji për ratifikim të Konventës për të Drejtat e Personave me Invaliditet dhe Protokolli Fakultativ si shtojcë të Konventës për të Drejtat e Personave me Invaliditet),
- ▶ Deklarata e UNESCO-s për Arsim të Bazuar mbi Nevojat e Posaçme nga Salamanka (Deklarata e Salamankës),
- ▶ Konventa për të Drejtat e Fëmijës,
- ▶ Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve,
- ▶ Rregullorja për standardet dhe normat për veprimin e institucioneve për fëmijë, dhe
- ▶ Dokumenti për vlerësim të suksesit të aktiviteteve të planifikuara të planit zhvillimor.

## SHTOJCA 2

### PYETËSOR për institucionet parashkollore

#### EMRI I KOPSHTIT:

Në sa objekte (klone) punon kopshti juaj?

\_\_\_\_\_

Vendi: \_\_\_\_\_

Komuna: \_\_\_\_\_

#### 1. JU LUTEMI SHKRUANI NUMRIN TOTAL TË FËMIJËVE NË KOPSHTINTUAJ DHE TË GJITHË OBJEKTEVE NË VITIN AKTUAL 2017/18 DHE STRUKTURËN E TYRE.

	meshkuj	femra	gjithsej
Fëmijë të regjistruar			
Maqedonas			
Shqiptarë			
Turq			
Romë			
Vllahë			
Serbë			
Boshnjakë			
E tjerë			
Numri i fëmijëve të regjistruar me aftësi të kufizuara			

**2. JU LUTEMI SHKRUANI NUMRIN DHE STRUKTURËN E GRUPEVE NË KOPSHTIN DHE OBJEKTET TUAJ NË VITIN AKTUAL 2017/18.**

MOSHA E FËMIJËVE	Numri total i grupeve	Numri total i fëmijëve në grupet	Numri total i fëmijëve me aftësi të kufizuara në grupet
deri në 12 muaj			
12 muaj deri në 18 muaj			
Mbi 18 muaj dhe deri në 2 vjet			
Mbi dy vjet dhe deri në tre vjet			
Mbi tre vjet dhe deri në katër vjet			
Mbi katër vjet dhe deri në pesë vjet			
Mbi pesë vjet dhe deri në gjashtë vjet			

2-a. Në qoftë se në kopshtin ka grup me fëmijë me aftësi të kufizuara, a janë në grupin angazhuar më shumë punonjës, domethënë a ka në grupin më shumë edukatorë dhe/ose kujdestarë? Ju lutemi përshkruani shkurtimisht.

---



---

**3. STRUKTURA ETNIKE E NUMRIT TOTAL I FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA NË KOPSHTIN (SHKRUANI NUMRAT E NXËNËSVE):**

- Maqedonas: \_\_\_\_\_
  Shqiptarë: \_\_\_\_\_
  Turq: \_\_\_\_\_  
 Romë: \_\_\_\_\_
  Serbë: \_\_\_\_\_
  Vllahë: \_\_\_\_\_  
 Boshnjakë: \_\_\_\_\_
  E tjerë: \_\_\_\_\_

**4. SA PREJ FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA TË REGJISTRUAR NË KOPSHTINTUAJ NË VITIN AKTUAL 2017/18 PËRBALLOHEN ME KËTO PENGESA (SHËNOJENI NUMRAT E FËMIJËVE)?**

- fëmijë me aftësi të kufizuara intelektuale:  
(pengesa në zhvillimit psikik)
- fëmijë me aftësi të kufizuara intelektuale:  
(fëmijë që kanë vështirësi në lëvizje të krahëve, këmbëve ose tërë trupit, fëmijë me paralizë cerebrale, fëmijë që përdorin karroca ose mjete të tjerë ndihmëse për të lëvizur.)
- fëmijë me pengesa në shikim:  
(Dëmtim nga një lloj më i vështirë që e pengon fëmijën të marrë pjesë në aktivitetet)
- fëmijë me pengesa në të dëgjuarit dhe/ose të folurit  
(Dëmtim nga një lloj më i vështirë që e pengon fëmijën të marrë pjesë në aktivitetet)
- fëmijë me më shumë aftësi të kufizuara:  
(kombinim i disa pengesave)
- fëmijë me autizëm:  
(spektri autistik i çrregullimeve)
- e tjerë (ju lutem shkruani):

---



---



---

**VËREJTJE:**

Ju lutem, çdo fëmijë numërojeni vetëm një herë. Nëse në kopshtin ka fëmijë me më shumë aftësi të kufizuara (të kombinuara), shënojeni atë fëmijë vetëm në rreshtin “fëmijë me më shumë aftësi të kufizuara”

**Njëkohësisht, ju lutem përshkruani se çfarë janë vështirësitë të kombinuara d.m.th. Pengesat e kombinuara:**

---



---



---

**5. A KA NDODHUR NË TRI VITET E FUNDIT QË KOPSHTI JUAJ TË MOS JETË NË GJENDJE TË PRANOJË NDONJË NXËNËS ME AFTËSI TË KUFIZUARA?**

po

jo

**Nëse po, ju lutem shpjegojini arsyet:**

---

---

---

**6. NË CILËN MËNYRË KOPSHTI JUAJ I IDENTIFIKON FËMIJËT ME AFTËSITË KUFIZUARA? MUND TË SHËNONI MË SHUMË SE NJË OPSION:**

- prindërit kanë dorëzuar dokument (d.m.th. mendim mjekësor për llojin dhe shkallën e pengesës) nga institucion përkatës për aftësinë e kufizuar me të cilën po përballohet fëmija
- prindërit e kanë njoftuar shkollën gojarisht për aftësinë e kufizuar me të cilën po përballlet fëmija
- nëpërmjet vlerësimit nga ana e shërbimit profesional, të arsimtarëve dhe prindërve e fëmija
- nëpërmjet vlerësimit nga ana e shërbimit profesional dhe të arsimtarëve
- tjetër (ju lutemi shënoni):

---

---

---

**7. KUR PRINDËRIT E PLOTËSOJNË FORMULARIN PËR REGJISTRIM, SI ËSHTË PËRVOJA JUAJ NË LIDHJE ME NJOFTIMIN DHE PARALAJMËRIMIN PËR PENGESAT E FËMIJËS SË TYRE?**

- Në të gjithë rastet deri tani, prindërit kanë dorëzuar dokument nga institucion përkatës për aftësinë e kufizuar me të cilën po përballohet fëmija
- Në shumicën e rasteve deri tani, prindërit kanë dorëzuar dokument nga institucion përkatës për aftësinë e kufizuar me të cilën po përballohet fëmija

- Në shumë pak raste deri tani, prindërit kanë dorëzuar dokument nga institucion përkatëse për aftësinë e kufizuar me të cilën po përballohet fëmija
  - Deri tani, prindërit asnjëherë nuk kanë dorëzuar dokument nga institucion përkatëse për aftësinë e kufizuar me të cilën po përballohet fëmija
  - E tjerë (Ju lutemi shpjegoni):
- 
- 
- 

**8. ÇFARË PËRSHTATJESH JANË BËRË PËRTË SIGURUAR QASJE FIZIKE NË KOPSHTINTUAJ (DUKE I PËRFSHIRË TË GJITHË OBJEKTET E KOPSHTIT)? MUND TË SHËNONI MË SHUMË SE NJË OPSION:**

- rampa aksesuese në hyrjen e kopshtit dhe të kloneve
  - ashensor i jashtëm në hyrjen e kopshtit dhe të kloneve
  - hapësira të përshtatura të brendshme në kopshtin (p.sh. hapësirë për punë individuale me nxënësit me aftësi të kufizuara, sallë të përdorshme për fëmijët me aftësi të kufizuara etj.)
  - tualete të adaptuara
  - ashensor i brendshëm për lëvizje nëpër katet
  - nuk janë ndërmarrë masat e nevojshme për lehtësim të qasjes për fëmijët me aftësi të kufizuara
  - e tjerë (ju lutemi shënoni):
- 
- 
-

9. A KA NË DISPOZICION KOPSHTI JUAJ MJETETË ADAPTUARA PEDAGOGJIKE-DIDAKTIKE DHE MJETE NDIHMËSE (LODRATË PËRSHTATURA EDUKATIVE, LIBRA ME ILUSTRIME, KARTELA DHE FOTOGRAFI PËR KOMUNIKIM ETJ.)?

po

jo

**Nëse po, ju lutemi shkruani se cilët janë ata:**

---

---

10. A PËRDORNI NË PUNËN ME FËMIJËT NË KOPSHTIN TUAJ TEKNOLOGJI INFORMATIKE?

po

jo

**Nëse po, ju lutemi shkruani se cilat janë ato:**

---

---

11.A KA DEFEKTOLOG NË SHËRBIMIN PROFESIONAL NË KOPSHTIN TUAJ?

po, në kopshtin tonë punon defektolog me kohë të plotë pune

po, në kopshtin tonë punon defektolog "lëvizës" (punon edhe në disa kopshte të tjera)

po, në kopshtin tonë punon defektolog – vullnetar

jo

12. JU LUTEMI SHËNONI SE CILAT PROFILE PROFESIONALE KENI NË SHËRBIMIN PROFESIONAL NË KOPSHTIN TUAJ:

pedagog

psikolog

punëtor social

defektolog

logoped

e tjerë (ju lutemi shënoni):

---

---

---

**13. NË LIDHJE ME KUALIFIKIMIN E SHËRBIMIT PROFESIONAL PËR PUNË ME FËMIJË ME AFTËSITË KUFIZUARA, JU LUTEMI PËRZGJIDHNI OPSIONIN QË E PËRSHKRUAN SITUATËN MË MIRË NË KOPSHTINTUAJ:**

- shërbimi profesional është tërësisht i kualifikuar për punë me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe nuk ka nevojë për trajnime shtese
- shërbimi profesional i avancion vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë për punë me fëmijë me aftësi të kufizuara nëpërmjet trajnimeve dhe seminareve të ndryshme
- shërbimi profesional ka nevojë për avancim të njohurive dhe shkathtësive për punë me fëmijë me aftësi të kufizuara, por nuk ofrohen mjaft mundësi për pjesëmarrje në trajnime dhe seminare nga kjo fushë
- avancimi i njohurive dhe shkathtësive për punë me fëmijë me aftësi të kufizuara nuk është prioritet për shërbimin profesional

**14. NË LIDHJE ME KUALIFIKIMITTË KUJDESTAREVE PËR PUNË ME FËMIJË ME AFTËSITË KUFIZUARA, JU LUTEMI PËRZGJIDHNI OPSIONIN QË MË MIRË E PËRSHKRUAN SITUATËN NË KOPSHTINTUAJ:**

- kujdestarët janë tërësisht të kualifikuar për punë me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe nuk kanë nevojë për trajnime shtese
- kujdestarët i avancojnë vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë për punë me fëmijë me aftësi të kufizuara përmes trajnimeve dhe seminareve të ndryshme
- kujdestarët kanë nevojë për avancim të njohurive dhe shkathtësive për punë me fëmijë me aftësi të kufizuara, por nuk ofrohen mjaft mundësi për pjesëmarrje në trajnime dhe seminare nga kjo fushë
- avancimi i njohurive dhe shkathtësive për punë me fëmijë me aftësi të kufizuara nuk është prioritet për kujdestarët



**15. NË CILËN MËNYRË E EVIDENTONI DHE DOKUMENTONI PUNËN ME FËMIJËT ME AFTËSITË KUFIZUARA NË KOPSHTIN TUAJ? MUNDTË SHËNONI MË SHUMË SE NJË OPSION:**

- për çdo fëmijë me aftësi të kufizuara formohet dhe funksionon një ekip i cili përfshin edhe prindin e fëmijës dhe kujdeset për vlerësim dhe plotësim të nevojave dhe mundësive të fëmijës;
- edukatorët në grupet e të cilëve ka fëmijë me aftësi të kufizuara, së bashku me ekipin profesional, bëjnë vlerësim, i evidentojnë dhe i dokumentojnë arritjet e fëmijës dhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohet;
- në kopshtin tonë nuk ka ndonjë mënyrë përkatëse për evidentim dhe dokumentim të punës me aftësi të kufizuara, me ata po zbatohen procedurat e njëjta si dhe me fëmijët e tjerë;
- kopshti ynë nuk i evidenton aktivitetet, nevojat dhe mundësitë e fëmijëve me aftësi të kufizuara, dhe
- nuk ka fëmijë me aftësi të kufizuara në kopshtin tonë.

**Ju lutem shpjegojini detajet:**

---

---

---

**A zhvillon dhe zbaton procedura të brendshme speciale për vlerësim, ndjekje, evidentim dhe dokumentim të avancimit dhe vështirësive të fëmijëve me pengesa ekipi juaj? Nëse përgjigja është po, ju lutemi shpjegoni se çfarë përmbajnë këto procedura:**

---

---

---

**16. CILAT JANË VËSHIRËSITË MËTË MËDHA METË CILAT PËRBALLOHENI GJATË PUNËS ME FËMIJË ME AFTËSITË KUFIZUARA NË KOPSHTIN TUAJ? (MUNDTË PËRZGJIDHNI MË SHUMË SE NJË OPSION).**

- Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në aktivitetet me fëmijët e tjerë;
  - Vendosja e komunikimit dhe interaksionit me fëmijët me aftësi të kufizuara;
  - Përgatitja e planeve individuale për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara:
  - Ndjekja dhe evidentimi i avancimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara;
  - Senzibilizimi i fëmijëve të tjerë dhe prindërve të tyre me nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
  - Vendosja e komunikimit dhe bashkëpunimit me familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përfshirë në grupet në kopshtin.
  - Tjetër:
- 
- 

**17. A PËRGATITEN DHE ZBATOHEN PLANE INDIVIDUALE PUNE PËR FËMIJËT ME AFTËSITË KUFIZUARA NË KOPSHTIN TUAJ?**

- plan individual përgatitet dhe zbatohet për çdo fëmijë me aftësi të kufizuara
  - plan individual përgatitet dhe zbatohet nga një pjesë e edukatorëve të cilët janë trajnuar për atë
  - nuk përgatiten as zbatohen plane individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara
  - nuk ka fëmijë me aftësi të kufizuar në kopshtin tonë
  - Ju lutemi jepni më shumë detaje rreth këtyre pyetjeve:
- 
-

**Cilat janë arritjet dhe sfidat kryesore në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e planeve individuale? A i përfshini prindërit në përgatitjen e planeve personale? Nëse po, në cilën pjesë të përgatitjes së planeve i përfshini?**

---

---

---

**Nëse në kopshtin tuaj ka fëmijë me aftësi të kufizuara, por ju nuk përgatisni plane individuale, cilat janë arsyet për këtë?**

---

---

**18. A KA FITUAR SHKOLLA JUAJ MJETE FINANCIARE SHITESË NGA PUSHTETI QENDROR OSE LOKAL PËR AVANCIMTË PËRFSHIRJES SË FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA NË VITIN AKTUAL 2017/18?**

- po    jo    nuk ka fëmijë me aftësi të kufizuara në kopshtin tonë

**Nëse po, ju lutemi shkruani për çfarë i keni shfrytëzuar mjetet financiare:**

---

---

**19. NË LIDHJE ME PJESËMARRJEN E NXËNËSVE ME AFTËSITË KUFIZUARA NË AKTIVITETET PLOTËSUESE DHE TË LIRA (FESTIME, VIZITA ETJ.), JU LUTEMI PËRZGJIDHNI OPSIONIN QË E PËRSHKRUAN MË MIRË SITUATËN NË KOPSHTINTUJ:**

- kopshti i përgatit dhe i përshtat aktivitetet plotësuese në mënyrë që mundëson pjesëmarrje të barabartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në përputhje me interesat e tyre personale
- fëmijët me aftësi të kufizuara përfshihen në pjesë të aktiviteteve plotësuese, të cilave mund t'u përshtaten për shkak të aftësive të kufizuara
- fëmijët me aftësi të kufizuara nuk marrin pjesë në aktivitetet plotësuese
- nuk ka fëmijë me aftësi të kufizuara në kopshtin tonë

**20. SI SILLEN MË SHPESH FËMIJËT E TJERË ME FËMIJËT ME AFTËSITË KUFIZUARA? (JU LUTEMI PËRZGJIDHNI OPSIONIN QË MË MIRË E PËRSHKRUAN SITUATËN NË KOPSHTINTUAJ):**

- i pranojnë si anëtarë të barabartë, i ndihmojnë në aktivitetet dhe shoqërohen me ata edhe jashtë kopshtit
  - i trajtojnë me respekt dhe ndajmë më ata materiale, por interaksioni është kryesisht i kufizuar në aktivitetet në kopshtin
  - ka komunikim të kufizuar për shkak se fëmijët pa aftësi të kufizuara mendojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara nuk mund të marrin pjesë në lojërat dhe zbavitjet
  - fëmijët me aftësi të kufizuara nuk janë pranuar dhe nuk marrin pjesë në jetën sociale së bashku me bashkëmoshatarët e tyre
  - fëmijët me aftësi të kufizuar janë të ofenduar dhe tallur nga ana e shokët e tyre
  - nuk ka fëmijë me aftësi të kufizuara në kopshtin tonë
  - tjetër (ju lutemi shpjegoni):
- 
- 

**21. CILI ËSHTË REAGIMI MË I SHPESHTË I PRINDËRVE TË FËMIJËVE TË TJERË NË LIDHJE ME PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA NË GRUPET E RREGULLTA?**

- e përkrahin përfshirjen e këtyre fëmijëve si anëtarë me të drejta të barabarta dhe i inkurajojnë fëmijët e tyre që të shoqërohen, të bashkëpunojnë dhe t'i ndihmojnë fëmijët me aftësi të kufizuara
- e pranojnë përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara
- nuk kanë ose nuk shprehin qëndrim rreth përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara
- nuk pranojnë përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara për shkak se mendojnë që kjo e zvogëlon cilësinë dhe dinamikën e aktiviteteve, por nuk ndërmarrin iniciativa për ta ndaluar inkluzionin
- ndërmarrin aktivisht iniciativa në kopshtin dhe instanca të tjera për çregjistrim të fëmijëve me aftësi të kufizuara nga grupet ku mësojnë fëmijët e tyre

- nuk ka fëmijë me aftësi të kufizuar në kopshtin tonë
  - tjetër (ju lutemi shënoni):
- 
- 

**22. ME CILËT AKTORË SHOQËRORË KA PASUR SHKOLLA JUAJ BASHKËPUNIM PËR AVANCIM TË INKLuzionIT TË NXËNËSVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA? (MUND TË PËRZGJIDHNI DISA OPSIONE)**

- me kopshtet e tjera
- me shkollat fillore
- me komunën
- me institucionet e tjera lokale
- me institucionet shtetërore arsimore dhe me institucione të tjera relevante
- me organizatat e shoqërisë civile
- kopshti nuk ka pasur bashkëpunim me aktorë të tjerë

**Ju lutemi shkurtimisht përshkruanin bashkëpunimin dhe arritjet:**

---

---

**23. КОЈА ОД НАВЕДЕНИТЕ ОПЦИИ НАЈБЛИСКУ ГО ОДРАЗУВА СТАВОТ НА ВАШАТА ГРАДИНКА ВО ВРСКА СО ИНКЛУЗИВНОТО ПРЕДУЧИЛИШНО ОБРАЗОВАНИЕ?**

- arsimi parashkollor gjithëpërfshirës është i domosdoshëm dhe në favor të mirë të të gjithë fëmijëve
- arsimi parashkollor gjithëpërfshirës është mundësi e përshtatshme vetëm për një pjesë e fëmijëve me aftësi të kufizuar, të cilët mund të përfshihen në aktivitetet
- arsimi parashkollor gjithëpërfshirës, në formën në të cilën po zbatohet te ne, nuk është formë e domosdoshme për fëmijët me pengesa
- fëmijët me aftësi të kufizuar nuk duhet të përfshihen në arsimin parashkollor

**24. JU LUTEMIT'Ë NOTONI SIPAS NIVELITË RËNDËSISË, DUKE FILLUAR NGA MË E RËNDËSISHME DERI NË MË PAK E RËNDËSISHME, ME NOTA NGA 1 DERI NË 7, NEVOJAT PRIORITARE TË CILAT DOTË KONTRIBUOJNË MË SHUMË NË AVANCIMIN E GJITHËPËRFSHIRJES (INKLUZIONIT) TË FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA NË KOPSHTINTUAJ:**

NEVOJAT PRIORITARE	NIVELI I RËNDËSISË
<input type="checkbox"/> të punësohet defektolog në kopsht	
<input type="checkbox"/> trajnime për edukatorët për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara	
<input type="checkbox"/> trajnime për shërbimin profesional për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe për mbështetje të edukatorëve	
<input type="checkbox"/> përmirësim i qasjes fizike në objektet	
<input type="checkbox"/> sigurim i mjeteve të adaptuara pedagogjike-didaktike, mjete ndihmëse dhe teknologji	
<input type="checkbox"/> sigurim i më shumë mjeteve financiare për kopshtet për plotësim të nevojave individuale të fëmijëve me aftësi të kufizuara	
<input type="checkbox"/> ndryshime në kornizës ligjore	

tjetër, ju lutem shkruani:

---



---

**25. INFORMACIONE SHITESE OSE PROPOZIME NË LIDHJE ME PUNËN ME FËMIJËT ME AFTËSITË KUFIZUAR:**

---

---

---

---

---

---

---

**Emri dhe mbiemri:**

---

**Pozita pune në kopshtin:**

---

**Informacione për kontakt të plotësuesit të anketës:**

tel.: \_\_\_\_\_ celular: \_\_\_\_\_ e-mail: \_\_\_\_\_

**Data e plotësimit:**

---

**Nënshkrim dhe vulë:**

---

**JU FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN!**

# SHTOJCA 3

## RAPORT

### nga vizita dhe intervista në institucionin parashkollor

Data e intervistës:

---

Emri i intervistuesit:

---

Personi/personat të intervistuar:

1. (emri dhe mbiemri, pozita, informacione për kontakt)
- 2.
- 3.

#### TË DHËNAT PËR INSTITUCIONIN PARASHKOLLOR

Emri i plotë i institucionit parashkollor		
Vendi, komuna		
Rajoni		
Numri i objekteve		
Gjuha mësimore	<input type="checkbox"/> gjuha maqedonase <input type="checkbox"/> gjuha turke	<input type="checkbox"/> gjuha shqipe <input type="checkbox"/> gjuha serbe



**1. CILI ËSHTË NUMRI I PËRGJITHSHËM I FËMIJËVE TË REGJISTRUAR NË KOPSHTIN TUAJ NË VITIN AKTUAL 2017/18?**

NUMRI I FËMIJËVE	meshkuj	femra	gjithsej

**2. SA FËMIJË ME AFTËSITË KUFIZUARA JANË REGJISTRUAR NË ÇDO NGA GRUPE TË NDRYSHME MOSHE NË VITIN AKTUAL 2017/18?**

NUMRI I FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA NË:	grupi						gjithsej
	Deri në 11 muaj	12-23 muaj	24-35 muaj	36-47 muaj	48-59 muaj	60-71 muaj	

**3. SA FËMIJË ME AFTËSITË KUFIZUARA JANË REGJISTRUAR NË KOPSHTIN TUAJ NË VITIN AKTUAL 2017/18, SIPAS LLOJITË AFTËSISË SË KUFIZUAR?**

LLOJI I AFTËSISË SË KUFIZUAR	NUMRI I FËMIJËVE
aftësi të kufizuara fizike	
pengesa në shikim	
pengesa në të dëgjuarit dhe/ose të folurit	
më shumë aftësi të kufizuara	
autizëm (spektri autistik i çrregullimeve)	
me aftësi të kufizuara fizike	
Tjetër (nëse ka, ju lutem shkruani)	
<b>GJITHSEJ:</b>	

**Përdoreni terminologjinë e pyetësorit tonë në lidhje me llojet e pengesave dhe shpjegimeve shtese. Shkurtimisht bisedoni për gjendjen e secilit prej fëmijëve me aftësi të kufizuara që të siguroheni se bashkëbiseduesit saktësisht kanë përcaktuar llojin e pengesës.**

4. CILA ËSHTË STRUKTURA ETNIKE E FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARATË REGJISTRUAR NË KOPSHTINTUAJ NË VITIN AKTUAL 2017/18?

KOMUNITETI ETNIK	NUMRI I FËMIJËVE
Maqedonas	
Shqiptarë	
Turq	
Romë	
Serbë	
Vllahë	
Boshnjakë	
E tjerë (nëse ka, shënoni)	
<b>GJITHSEJ:</b>	

**Krahasojini përgjigjet nga pyetësit. Nëse ka dallime, vazhdoni me pyetjen nr.5, nëse jo, kaloni te pyetja nr.6.**

5. CILA ËSHTË ARSYEJA PËR MOSPËRPUTHJET MIDISTË DHËNAVE AKTUALE DHE PËRGJIGJEVE QË I KENI DHËNË NË PYETËSORIN MË PARË? A BËHET FJALË PËR NDRYSHIM NË NUMRIN E FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA OSE E KENI RISHIKUAR VLERËSIMIN?

---



---



---

6. NË CILËN MËNYRË KOPSHTI PËRCAKTON SE CILËT FËMIJË JANË ME AFTËSITË KUFIZUARA? CILAT BURIME INFORMATASH I PËRDORNI? NË CILËN MËNYRË I PËRCAKTONI DHE EVIDENTONI "NEVOJAT E VEÇANTA" E FËMIJËS?

---



---



---

7. SA JANËTË HAPUR PËR KOMUNIKIM PRINDËRIT E FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA, KUR BËHET FJALË PËR NJOFTIMIN PËR GJENDJEN E TYRE? A KA NDODHUR DERITANI QË VETË PRINDËRIT, NËPËRMJET FORMULARIT PËR REGJISTRIM, T'JU NJOFTOJNË PËR PENGESËN E FËMIJËS SË TYRE?

---

---

---

8. JU LUTEMI PËRSHKRUANI (NËSE KENI PASUR NDONJËHERË PËRVOJË TË TILLË) SITUATË KU KOPSHTI NUK KA QENË NË GJENDJE TË PRANOJË NDONJË FËMIJË ME AFTËSITË KUFIZUAR? CILAT ISHIN ARSYET? SI E KOMUNIKUAT KËTË SITUATË ME FAMILJEN?

---

---

---

9. ÇFARË PËRSHTATJESH JANË BËRË QË TË SIGUROHET QASJE FIZIKE NË KOPSHTIN? ME ÇFARË MJETESH (TË ADAPTUARA) PEDAGOGJIKE-DIDAKTIKE DHE MJETESH NDIHMËSE DISPONON KOPSHTI? NË FUND TË INTERVISTËS, KËRKONI QË T'I SHIKONI PËRSHTATJET TË HAPËSIRËS, MJETET NDIHMËSE DHE SHËNOJINI KOMENTET TUAJ NË LIDHJE ME GJENDJEN DHE FUNKSIONALITETIN E TYRE.

**Gjetje dhe vërejtje nga vëzhgimit:**

---

---

---

---

**10. CILA ËSHTË PËRBËRJA E SHËRBIMIT PROFESIONALTË KOPSHTIT? CILI ËSHTË ROLI ITIJ NË PUNËN ME FËMIJËT ME AFTËSITË KUFIZUARA? A ËSHTË TRAJNUAR SHËRBIMI PROFESIONAL PËR ROLIN E PARASHIKUAR? SIPAS JUSH, A JANË MJAFT TRAJNUAR?**

---

---

---

**11. A JANË EDUKATORËTTË PËRGATITUR PËR PUNË ME FËMIJË ME AFTËSITË KUFIZUARA? ÇFARË TRAJNIMESH KANË MARRË EDUKATORËT PËR PUNË ME FËMIJËT ME AFTËSITË KUFIZUARA DHE SA ËSHTË NUMRI I EDUKATORËVE QË KANË PASUR MUNDËSITË MARRIN PJESË NË KËTO TRAJNIME NË TRI VITET E FUNDIT?**

---

---

---

**12. SI BASHKËPUNON KOPSHTI ME PRINDËRIT E FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA? SI SIGURON KOPSHTI KOMUNIKIMTË RREGULLT DHE SHKËMBIMTË INFORMACIONEVE ME PRINDËRIT E KËTYRE FËMIJËVE? SI I PËRFSHIN KOPSHTI PRINDËRIT NË PËRMIRËSIMIN E MUNDËSIVE PËR FËMIJËT E TYRE? CILAT JANË SFIDAT DHE MUNDËSITË PËR AVANCIMTË BASHKËPUNIMIT ME PRINDËRIT E FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA?**

---

---

---

---

**13. SI I NJOFTON KOPSHTI INSTITUCIONET KOMPETENTE LOKALE DHE SHTETËRORE PËR IDENTIFIKIMIN E FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA? A PRANON KOPSHTI MJETE FINANCIARE SHTESE PËR AVANCIMTË PËRFSHIRJES SË FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA?**

---

---

---

**14. SI E INKURAJON SHKOLLA PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA NË AKTIVITETET SHTESE DHE TË LIRA (FESTIME, VIZITA ETJ.)? NËSE FËMIJËT ME AFTËSITË KUFIZUARA NUK MARRIN PJESË NË KËTO AKTIVITETE, CILAT JANË ARSYET?**

---

---

---

**15. SI SILLEN FËMIJËT PA AFTËSITË KUFIZUARA ME FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA? CILAT JANË SFIDAT? SI I INKURAJON SHKOLLA FËMIJËT PA AFTËSITË KUFIZUARAT'I PRANOJNË DHE T'I MBËSHITESIN BASHKËMOSHATARËT E TYRE ME AFTËSITË KUFIZUARA?**

---

---

---

---

---

**16. CILI ËSHTË QËNDRIMI I PRINDËRVETË FËMIJËVE PA AFTËSITË KUFIZUARA NDAJ PËRFSHIRJES SË FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA NË GRUPET E RREGULLTA? CILAT JANË SFIDAT, A KA PASUR DERITANI NDNJË REAGIM DHE ANKESË KUNDËR PËRFSHIRJES SË FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA? SI I NXIT KOPSHTI PRINDËRIT E FËMIJËVE PA AFTËSITË KUFIZUARA TA PËRKRAHIN PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA NË ARSIMIN PARASHKOLLOR?**

---

---

---

**17. A BASHKËPUNON KOPSHTI ME AKTORËTË TJERË SOCIALE (INSTITUCIONET LOKALE DHE SHTETËRORE, ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE, SEKTORIN E BIZNESIT, MEDIAT, ETJ.) NË DREJTIMTË PËRMIRËSIMITTË PËRFSHIRJES SË FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA? NËSE PO: ME CILËT AKTORË? ÇFARË ISHTE BASHKËPUNIMI? CILAT JANË ARRITJET? NËSE JO, A KA PASUR NDNJË PËRPJEKJE PËR BASHKËPUNIM? ME KË? PSE PËRPJEKJA PËR BASHKËPUNIM NUK ISHTE E SUKSESSHME? NËSE NUK KA PASUR PËRPJEKJE PËR BASHKËPUNIM, CILAT ISHIN ARSYET PËR KËTË?**

---

---

---

**18. CILAT JANË NEVOJAT PRIORITARETË KOPSHTIT NË LIDHJE ME AVANCIMIN E PËRFSHIRJES SË FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA? ÇFARË DUHET TË PËRMIRËSOHET QË TË PËRFORCOHET KAPACITETI I KOPSHTIT PËRTË OFRUAR MUNDËSITË BARABARTA PËR FËMIJËT ME AFTËSITË KUFIZUARA?**

---

---

---

**19. INFORMACIONE SHITESË OSE PROPOZIME NË LIDHJE ME PUNËN ME FËMIJËT ME AFTËSITË KUFIZUARA QË DONIT'I NDANI ME NE?**

---

---

---

**HNë fund të intervistës, falënderojini për bashkëpunimin dhe ofroni informacionet tuaja për kontakt. Mos harroni që të bëni një shëtitje nëpër objektin që t'i shikoni përshtatjet e bëra për aksesueshmërinë fizike dhe t'i shikoni mjetet didaktike me të cilët disponon kopshti.**

**Komente dhe vërejtje gjatë intervistës:**

---

---

---

---

---

Shënoni komentet dhe vërejtjet të cilat i përkasin rrjedhjes së intervistës (dinamika, disponimi i bashkëbiseduesve për përgjigje të hapura etj.) ose të atmosferës në kopshtin, që nuk janë përhapur me pyetje të këtij udhëzuesi.

## SHTOJCA 4:

### PYETJET

#### PËR FOKUS GRUPIN ME PERSONAT UDHËHEQËS NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE

1	Sa gjatë jeni në pozitën udhëheqëse? Në këtë periudhë, sa shpesh takoheni me çështje dhe tema të lidhura me aftësi të kufizuara?
2	Si është përvoja juaj, si institucion parashkollor, në lidhje me regjistrimin dhe përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara? Nëse bëni një paralel, a ka interes më të madh për regjistrim tani në dallim me situatën para 10 vjet? Nëse po, çfarë mendoni se është arsye për këtë dallim?
3	Çfarë informatash keni në disponim në lidhje me numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtin tuaj? Në cilën mënyrë kopshti tuaj përcakton se kush janë fëmijët me aftësi të kufizuara? Çfarë burimesh të informatave po i përdorni? Në cilën mënyrë i identifikoni dhe i evidentoni "nevojat e veçanta" të fëmijës?
4	A keni qenë deri tani në situatë ku kopshti nuk ka qenë në gjendje të pranojë ndonjë fëmijë me aftësi të kufizuar? Cilat ishin arsyet? Si e komunikuat këtë situatë me familjen?
5	Çfarë masash ndërmerrni që të përmirësohet aksesueshmëria fizike në kopshtin?
6	A disponon kopshti me resurse dhe mjete ndihmëse të nevojshme për punën me fëmijë me aftësi të kufizuara?
7	Si është perceptimi juaj në lidhje me pranimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara nga ana e bashkëmoshatarëve të tyre? Çfarë janë reagimet më të shpeshta të bashkëmoshatarëve kur në grupin ka ndonjë fëmijë me aftësi të kufizuara?



8	Si është qëndrimi i prindërve të fëmijëve pa aftësi të kufizuara në lidhje me përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në grupin e fëmijëve të tyre? Cilat janë sfidat, çfarë reagimesh keni pasur deri tani në lidhje me përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara?
9	Në cilën mënyrë e inkurajoni inkluzionin në kopshtin? Me çfarë metodash ndikohet mbi kuadrin, fëmijët dhe prindërit që ta pranojnë inkluzionin dhe të ndikojnë mbi procesin e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara?
10	A mendoni se edukatorët, kujdestarët dhe anëtarët e shërbimit profesional janë motivuar për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara? Çfarë është ajo që mungon që motivimi të jetë më i madh? Kush mund të ju ndihmojë në këtë proces?
11	A keni bashkëpunuar deri tani institucionet lokale, organizatat e shoqërisë civile, shkollat, sektorin e biznesit, për aktivitete për ngritje të vetëdijes mbi rëndësinë e inkluzionit në moshën parashkollore?
12	A keni marrë pjesë deri tani në ngjarje, takime, konferenca, në të cilat u diskutua për këtë çështje? Sa, sipas Jush, kjo temë është me rëndësi dhe meriton vëmendje?
13	Çfarë mendoni se është sfida më e madhe në punën tuaj me fëmijët me aftësi të kufizuara? Si mund të tejkalohet?
14	Cilat janë mendimet tuaja për mënyrat e mundshme për përmirësim të inkluzionit në institucionet parashkollore?

## PYETJET

### PËR FOKUS GRUPIN ME PRINDËRIT E FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA

1	Në cilin kopsht është përfshirë fëmija juaj? Në cilin grup sipas moshës? Pse keni vendosur ta regjistroni në këtë kopsht?
2	A keni hasur vështirësi gjatë regjistrimit në kopshtin? Nëse po, cilat vështirësi? A është ky kopshti i parë në të cilin është përfshirë fëmija juaj?
3	Si e vlerësoni qasjen e shkollës ku mëson fëmija juaj? A mund të lëvizë fëmija juaj në tërë objektin pa ndihmë? Nëse jo, kush i jep përkrahje kur shkon në shkollë?
4	A punon fëmija juaj sipas një plani individual pune? Nëse po, a ju kanë konsultuar edukatori/ët që e kanë përpiluar atë plan gjatë përgatitjes së planit? Cili është mendimi juaj për planin individual që përdor fëmija juaj? Nëse jo, a mendoni se fëmija juaj ka nevojë për një plan individual pune?
5	Çfarë mendoni për mbështetjen e ofruar nga shërbimi profesional i kopshtit? A merr fëmija juaj mbështetjen e nevojshme?
6	Si e vlerësoni mbështetjen që e merr fëmija nga edukatorët dhe kujdestarët? A merr fëmija juaj mbështetjen e nevojshme?
7	Si e vlerësoni bashkëpunimin dhe komunikimin me kopshtin në përgjithësi?
8	A konsultohet shërbimi profesional me ju në lidhje me nevojat dhe mundësitë të fëmijës suaj? A ju japin këshilla dhe udhëzime se si ju mund ta ndihmoni fëmijën tuaj dhe ku të kërkonti ndihmë shtese?

9	A merr pjesë fëmija juaj në aktivitete shtese dhe të lira (festime, vizita etj.)? Në cilat, në çfarë mënyre? A ekzistojnë aktivitete shtese në të cilat fëmija juaj donte të mernte pjesë, por kjo nuk ishte e mundur?
10	Si sillen bashkëmoshatarët ndaj fëmijës suaj? A është pranuar fëmija juaj nga bashkëmoshatarët? A e ndihmojnë ata në aktivitetet e përditshme? A shoqërohet fëmija juaj me bashkëmoshatarët edhe jashtë kopshtit?
11	Cili është qëndrimi i prindërve të bashkëmoshatarëve të grupit të fëmijës suaj në lidhje me përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor?
12	Çfarë mendoni se është më e mira për fëmijën tuaj në kopshtin?
13	Çfarë mendoni se është sfida më e madhe për fëmijën tuaj në kopshtin?
14	Ku planifikoni ta regjistroni fëmijën tuaj pas mbarimit të kopshtit? Çfarë zgjedhje do të bëni në lidhje me shkollën fillore? Në bazë të çfarë do të bëni zgjedhjen?
15	Si mendoni se mund të përmirësohet përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor?

## PYETJET

### PËR FOKUS GRUPIN ME EDUKATORËT DHE PËRFAQËSUESIT E EKIBEVE PROFESIONALE NË KOPSHTET

1	A keni punuar me fëmijë me aftësi të kufizuara? Çfarë lloj aftësi të kufizuara përballën këta fëmijë?
2	Si i identifikoni fëmijët me aftësi të kufizuara? Si i përcaktoni nevojat e veçanta të fëmijëve me aftësi të kufizuara?
3	Si e vlerësoni përgatitjen dhe trajnimin tuaj për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara? Cilat trajnime po vizitoni, mbi cilat tema? Kur dhe prej kujt janë organizuar këto trajnime? Si ju ndihmuan trajnimet në punën tuaj të përditshme me fëmijët me aftësi të kufizuara? Në cilat tema mendoni se keni nevojë për trajnime shtese? Nëse jo, çfarë lloj trajnimi ju nevojitet?
4	A përgatisni plane individuale pune për fëmijët me aftësi të kufizuara? Nëse jo, cilat janë arsyet? Nëse po, si e përgatisni planin? Në cilën mënyrë i ndiqni dhe i evidentoni ndryshimet në zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara?
5	A keni resurset e nevojshme (mjetet didaktike-pedagogjike, mjetet ndihmëse) për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara? Si e vlerësoni aftësinë tuaj për t'i përdorur ato? Nëse jo, çfarë mungon?
6	Cili është roli i shërbimeve profesionale në lidhje me përkrahjes së kujdestarëve që punojnë me fëmijë me aftësi të kufizuara? Tregoni më shumë nga përvoja juaj.
7	Si e vlerësoni bashkëpunimin me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arritjen e qëllimeve të këtyre fëmijëve? Sa shpesh komunikoni me ata? Çfarë informacionesh shkëmbeni më shpesh? Në cilën mënyrë po komunikoni?

8	Si siguron përfshirjen e fëmijëve tuaj me aftësi të kufizuar në aktivitetet shtesë dhe të lira (festime, vizita etj.). Tregoni disa shembuj.
9	A e nxisni përkrahjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara nga ana e bashkëmoshatarëve të tyre? Çfarë aktivitetesh ndërmerrni për këtë? Ju lutemi shpjegoni shkurtimisht dhe tregoni disa shembuj. Në qoftë se nuk e keni nxitur deri tani, si planifikoni të bëni në të ardhmen?
10	A e nxisni përkrahjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara nga ana e prindërve të bashkëmoshatarëve të tyre? Çfarë aktivitetesh ndërmerrni për këtë? Ju lutemi shpjegoni shkurtimisht dhe tregoni disa shembuj. Në qoftë se nuk e keni nxitur deri tani, si planifikoni të bëni në të ardhmen?
11	A mendoni se arsimit parashkollor ofron mundësi të barabarta arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara? Ju lutemi shpjegoni.
12	Çfarë mendoni se është suksesi juaj më i madh në punën me fëmijët me aftësi të kufizuara? Cila është arsyeja për suksesin?
13	Çfarë mendoni se është sfida më e madhe në punën tuaj me fëmijët me aftësi të kufizuara? Si mund të tejkalohet?
14	A i ndiqni fëmijët me aftësi të kufizuara me të cilët keni punuar, pas mbarimit të kopshtit? Ku vazhdojnë me arsimin e tyre? A vendosni bashkëpunim me shkollat ku vazhdojnë? Për çfarë ju kontaktojnë më shpesh?
15	Cilat janë mendimet tuaja për mënyrat e mundshme për përmirësim të inkluzionit në institucionet parashkollore?

